

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5864
E enjte, 29 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Zgjedhjet 2019: A do ta gëlltitë kush bretkosën? | FAQE 11

Shkëlzen
MALIQI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KATËR SUBJEKTET MË TË FUQISHME POLITIKE PËLQEJNË TË GAROJNË
NDARAS NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE, POR ENDE NUK ËSHTË
PËRFUNDIMTARE NËSE DO TË NDODHË KËSHTU | FAQE 4-5

Nuk përjashtohen koalicionet e minutës së fundit



Njohësit e rrethanave politike në vend, Shkëlzen Maliqi dhe Imer Mushkolaj, kanë folur për mundësinë e koalicioneve parazgjedhore në minutat e fundit. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se lidhja e koalicioneve parazgjedhore në minutat e fundit është e mundshme. Maliqi dhe Mushkolaj kanë vlerësuar

se skenari i vitit 2017, ku në ditën e fundit u nënshkruan dy koalicione parazgjedhore, mund ta nxisë sërish çdo lëvizje të partive politike nga blloqet aktuale politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që afati i fundit për regjistrimin e koalicioneve parazgjedhore do të jetë data 30 gusht

AKTUALE

**POLICIA ARRESTON TETË
PERSONA TË DYSHUAR PËR
PROSTITUCION F. 8**



**DAKA: KQZ-ja NUK MERR
ASNJË VEPRIM PA NDARJEN E
BUXHETIT F. 6**

**28 FËMIJË ME PROBLEME NË
ZEMËR PO TRAJTOHEN NË
OKUK NGA KARDIOKIRURGËT
AMERIKANË F. 5**

EKONOMI

**ATK-ja, TATIMPAGUESVE:
DEKLAROJENI SAKTË
TATIMIN F. 9**

**NË TRE MUAJT E FUNDIT KA
RRITJE TË KËRKESAVE PËR
SHËRBIMET E VALËS F. 9**



SPORT

**KOSOVA NDAJ TURQISË
LUAN PËR FITORE F. 16**

**SOT SHORTI I LIGËS SË
KAMPIONËVE F. 17**

IKShPK-ja: Kujdes nga pickimi nga mushkonjat



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka kërkuar nga qytetarët të kenë kujdes nga pickimi nga mushkonjat për shkak të virusit Nil. Ky institut ka theksuar se

virusi në fjalë mund të shkaktojë sëmundje fatale neurologjike te njerëzit. Në këtë kontekst, IKShPK-ja nëpërmjet një njoftimi publik ka thënë se parandalimi efektiv i

infeksioneve nga virusi Nil varet nga zhvillimi i një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse dhe të integruar të mushkonjave dhe programeve të kontrollit në zonat ku mund të shfaqet | FAQE 3

Partitë politike përqendrohen në aderime

| FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kukan: Bojkoti i opozitës dëmton vendimin për negociatat

TIRANË, 28 GUSHT - Shqipëria ka pak shanse që të marrë çeljen e negociatave me BE në shator. Ky skenar tashmë pranohet edhe nga eurodeputetët që kanë mbështetur qeverinë "Rama" dhe deri pak ditë më parë thoshin se është në rrugë të mbarë.

Eduard Kukan, një nga politikanët e Parlamentit Evropian që është marrë gjatë më problemet e Shqipërisë në rrugën e integritit, thotë se Tirana ka ende probleme. Eduard Kukan, i cili kryesoi Grupin Punues të Ballkanit Perëndimor gjatë kohës së tij në PE, shpjegon se

Maqedonia e Veriut ka vite që i plotëson kriteret, por Unioni po e shtyn hapjen e negociatave, të cilat, ai beson, janë absolutisht të turpshme dhe demotivuese. Nga ana tjetër, ndërsa është i vetëdijshëm se Tirana po pret edhe një hap të ngjashëm, Kukani beson se situata në Shqipëri është krejtësisht e ndryshme. "Ata duhet të zbatojnë një reformë të madhe gjyqësore, opozita bojkoton parlamentin dhe, mbi të gjitha, shqiptarët nuk mund të gjejnë kompromise", theksoi ai.

Kukani është dhe më i prerë në qëndrimin e tij duke thënë se

"do të ishte joreale që Shqipëria të merrte datën për momentin". Lidhur me Maqedoninë e Veriut Kukan thotë se asaj "mund t'i jepet një datë specifike në samitin evropian në vjeshtë, të cilën unë e konsideroj realiste", thotë ish-deputeti, duke shtuar se, ndërsa Emmanuel Macron kishte deklarata shumë kategorike për këtë çështje, duket se ai tashmë po i lehtëson ato.

Eduard Kukan është një njohës i mirë i politikës në Tiranë dhe BE, dhe deklarata e sotme nuk është një parashikim, por gati një konfirmim i mos-hapjes së



negociatave. Një skenar i tillë, që cilësohet më negativ për vendin do të shënojë dhe dështimin më të madh të qeverisë "Rama". Të gjitha arsyet

e mosdhënies së statusit, reforma në drejtësi, bojkoti dhe mungesa e kompromisit janë llogari që kërkojnë përgjigjen nga PS dhe kryeministri, dhe jo opozita.

Meta: Zgjedhjet, e vetmja zgjidhje e krizës politike

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta në takim me deputeten gjermane Katja Leikert, ripërsëriti të mërkurën se e vetmja zgjidhje e krizës politike janë zgjedhjet, dhe se 13 tetori është një mundësi që nuk duhet humbur pasi vetëm do e përshkallëzonte më tej atë

TIRANË, 28 GUSHT - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta priti në një takim zëvendëskryetaren e Grupit Parlamentar të CDU/CSU, deputeten gjermane Katja Leikert.

Presidenti Meta vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë, dhe vëmendjen e posaçme që Gjermania po i kushton Shqipërisë, rajonit dhe perspektivës sonë evropiane. Kreu i shtetit e falënderoi për angazhimin e posaçëm të Bundestagut dhe veçanërisht të grupit parlamentar CDU/CSU për parandalimin e thellimit të krizës politike ku ndodhet

vendi, dhe theksoi se nëse do të ishin dëgjuar në kohë sugjerimet dashamirëse të drejtuesve të lartë të CDU-së, gjendja sot do të ishte krejt e ndryshme.

Presidenti Meta ripërsëriti se e vetmja zgjidhje e kësaj krize janë zgjedhjet, dhe se 13 tetori është një mundësi që nuk duhet humbur pasi vetëm do e përshkallëzonte më tej atë.

"Nëse politikanët vendas e kanë të pamundur të mësojnë nga vendet me përvojë të konsoliduar demokratike se si zgjidhen krizat, kanë rastin të mësojnë nga një shtet i ri si Kosova se si u jepet mundësia qytetarëve të thonë fjalën e tyre përmes



zgjedhjeve të parakohshme për të ardhmen e institucioneve qeverisëse", theksoi presidenti Ilir Meta.

Presidenti Meta, po ashtu, ka pritur në një takim

ambasadorin e Austrisë, Johann Sattler në përfundim të detyrës së tij në Shqipëri.

Në një mesazh në rrjetet sociale, Meta shkruan se "Ishte kënaqësi e veçantë të falënderoja

ambasadorin e Austrisë, Johann Sattler në përfundim të detyrës së tij, për angazhimin e palodhur për forcimin e gjithanshëm të marrëdhënieve të shkëlqyera midis dy vendeve tona".

Basha: Në vjeshtë nisin protestat

TIRANË, 28 GUSHT - Lulzim Basha ka zbuluar një pjesë të strategjisë së aksionit opozitar që do të nisë në muajin shtator.

Në një komunikim me gazetarët, Basha deklaroi se opozita do të jetë e fokusuar në tri drejtime kryesore; denoncimet për inkriminimin dhe korrupsionin e qeverisë, protesta masive dhe prezantimi i alternativës qeverisëse të PD-së me projekte konkrete. Basha tha se të tre këta elementë kanë qenë pjesë e aksionit opozitar, por në fillim të vjeshtës do të jenë me një ritëm edhe më të fortë.

Denoncimet për keqqeverisjen dhe kriminalizmin vijnë të jenë

temë e ditës e politikës. Pas largimit të Valdrin Pjetrit, si dhe daljes së dokumenteve komprometuese për Agim Kajmakun, PD-ja pret se në ditët e ardhshme do të dalin emra të tjerë të zyrtarëve të lartë të inkriminuar në PS. Basha deklaroi se janë edhe disa kandidatë me probleme ligjore të zgjedhur personalisht nga Edi Rama. Shumë shpejt, pasi strukturat e PD-së të verifikojnë dokumentet që i implikojnë, pritet të bëhen publikë dhe emrat e zyrtarëve të tjerë afër kryeministrit Edi Rama. Emrat që lakohen janë të shumtë dhe burime nga PD-ja thonë se denoncimet publikohen rast pas

rasti.

Rasti i Shkodrës dhe së fundit Vora janë treguesit se dhe katër vjet pas miratimit të Ligjit të dekriminalizimit modeli qeverisësi i Edi Ramës vijon të mbetet te figurat me të shkuar problematike. Denoncimet e zyrtarëve të inkriminuar në qeverinë e Ramës janë një nga fitoret e opozitës dhe kjo betejë do të jetë sërish në qendër të aksionit opozitar.

Zyrtarisht këtë vit opozita nuk ka qenë në pushime verore, pasi votimet moniste të 30 qershorit, ngjarjet në Shkodër dhe në qytete të tjera janë shoqëruar me protesta dhe tensione të forta.



IKShPK-ja: Kujdes nga pickimi nga mushkonjat

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka kërkuar nga qytetarët të kenë kujdes nga pickimi nga mushkonjat për shkak të virusit Nil. Ky institut ka theksuar se virusi në fjalë mund të shkaktojë sëmundje fatale neurologjike te njerëzit. Në këtë kontekst, IKShPK-ja nëpërmjet një njoftimi publik ka thënë se parandalimi efektiv i infeksioneve nga virusi Nil varet nga zhvillimi i një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse dhe të integruar të mushkonjave dhe programeve të kontrollit në zonat ku mund të shfaqet

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 28 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka kërkuar nga qytetarët e vendit tonë të kenë kujdes nga pickimi nga mushkonjat. Ky institut nëpërmjet një njoftimi publik ka bërë me dije se pickimi nga mushkonjat ose virusi Nil mund të shkaktojë sëmundje fatale neurologjike te njerëzit. "Virusi i Nilit Perëndimor (VNP) mund të shkaktojë sëmundje fatale neurologjike te njerëzit. Megjithëse, përafërsisht 80 për qind e njerëzve që janë të infektuar nuk tregojnë asnjë simptomë, virusi i Nilit Perëndimor transmetohet te njerëzit kryesisht nëpërmjet pickimit nga mushkonjat. Virus mund të shkaktojë sëmundje të rëndë dhe ngordhje të kuajve. Vaksinat për kuajt janë në dispozicion për përdorim, por jo ende në dispozicion për njerëzit. Zogjtë janë bartës natyralë të virusit të Nilit perëndimor", është thënë në njoftimin e IKShPK-së.

IKShPK-ja ka theksuar se Virus i Nilit Perëndimor (VNP) zakonisht gjendet në Afrikë, Evropë, Lindjen e Mesme, Amerikën Veriore dhe Azinë Perëndimore. "VNP është ruajtur në natyrë nëpërmjet ciklit i cili përfshinë transmetimin në mes zogjve dhe mushkonjave. Njerëzit,

kuajt dhe gjarët e tjerë mund të infektohen. Që nga paraqitja në vitin 1999 në ShBA, virusi është përhapur edhe në Kanada deri në Venezuelë", është thënë në këtë njoftim. Sipas këtij njoftimi, infeksioni te njerëzit me këtë virus kryesisht është rezultat i pickimit nga mushkonjat e infektuara. "Mushkonjat infektohen pasi ushqehen me gjakun e zogjve të infektuar, të cilat qarkullojnë virusin në gjakun e tyre për disa ditë. Virus përfundimisht futet në gjëndrat pështimore të

mushkonjave. Gjatë konsumimit të mëvonshëm të gjakut (kur mushkonjat thumbojnë), virusi mund të injektohet në njerëz dhe kafshë, prej ku shumëzohet dhe mund të shkaktojë sëmundje.

Virusi mund të bartet gjithashtu edhe nëpërmjet kontaktit me kafshët e tjera të infektuara, nga gjaku apo indet e tjera. Një përqindje shumë e vogël e infeksioneve në njerëz është paraqitur nëpërmjet transplantimit të organeve, transfuzionit të gjakut dhe me qumështin e gjirit. Është i regjistruar vetëm një rast i bartjes së virusit prej nënës te fëmija me rrugë transplacentare", është thënë në njoftimin e këtij instituti.

Më tutje, IKShPK-ja ka treguar se cilat janë simptomat që mund të shkaktohen nga ky virus. "Simptomat e sëmundjeve të rënda (të quajtura edhe sëmundje neuroinvasive, si encefaliti i Nilit Perëndimor ose Poliomieliiti i Nilit Perëndimor) përfshijnë: dhembje koke, temperaturë, shtrëngim në qafë, shtangje, dezorientim, komë, dridhje, konvulsione, dobësim të muskujve dhe paral-

izë. Është llogaritur se rreth 1 në 150 persona të infektuar me VNP do të zhvillohet një formë më e rëndë e sëmundjes. Sëmundja serioze mund të shfaqet te njerëzit e secilës moshë, mirëpo njerëzit mbi moshën 50-vjeçare dhe personat me imunitet të zbehur (p. sh., pacientët me transplantime) janë në rrezik të madh që të sëmurin rëndë pas infektimit me VNP", ka bërë me dije IKShPK-ja, duke treguar edhe mënyrën e parandalimit të VNP-së. "Pasi shpërthimet e epidemive të VNP-së ndodhin para rasteve në njerëz, ndërtimi i një mbikëqyrje shëndetësore aktive të shëndetit të kafshëve për gjetjen e rasteve të reja është esenciale për sigurimin e lajmërimit të hershëm për autoritetet veterinarë dhe shërbimet shëndetësore humane. Në mungesë të vaksinës, mënyra e vetme për ta zvogëluar infeksionin në njerëz është përmes vetëdijesimit dhe edukimit të popullatës rreth masave që mund të ndërmerren për ta zvogëluar rrezikun e ekspozimit ndaj virusit", është thënë në njoftimin e Institutit Kombëtar të

Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK).

Ky institut nëpërmjet këtij njoftimi ka porositur qytetarët e Kosovës që të kenë kujdes ndaj pickimit nga mushkonjat duke përdorur rrjeta, rroba të lehta me mëngë të gjata dhe të shmangen nga aktivitetet e jashtme në kohën e pickimit. Po ashtu, IKShPK-ja ka kërkuar të kenë kujdes edhe ndaj kafshëve të sëmura dhe të përdorin dorëza.

Në fund të këtij njoftimi ky institut ka thënë se parandalimi efektiv i infeksioneve në njerëz nga ky virus varet nga zhvillimi i një mbikëqyrje gjithëpërfshirëse dhe të integruar të mushkonjave dhe programeve të kontrollit në zonat ku shfaqet VNP-ja. "Punëtorët shëndetësorë që kujdesen për pacientët e dyshuar apo të konfirmuar me infeksion VNP, ose që punojnë me mostrat prej tyre, duhet t'i zbatojnë masat standarde parandaluese për kontrollin e infeksioneve. Mostrat e marra prej njerëzve ose kafshëve të dyshuara me infeksion VNP duhet të manipulohen nga stafi i trajnuar dhe në laboratorë të pajisur komplet", është thënë në njoftimin publik të IKShPK-së.



Veseli: Do ta luftojmë çdo formë abuzimi apo korrupsioni që pengon konkurrencën e lirë



PRISHTINË, 29 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, është zotuar se nëse do të jetë kryeministër i ardhshëm do ta luftojë çdo formë abuzimi apo korrupsioni që e pengon konkurrencën e lirë. "Këto ditë kam vizituar biznese të ndryshme që punësojnë dhe u krijojnë mundësi të rinjve, që ata të mos emigrojnë, por ta ndërtojnë të ardhmen e tyre në Kosovë. Një prej tyre është edhe

'Lona Al Plast' që, falë punës së madhe të biznesmenëve Nijazi Bytyqi dhe Ramadan Hoxha, prodhon jo vetëm për tregun vendor, por edhe për tregun e huaj", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se përmes Ministrisë së Financave kanë marrë masa të shumta për t'i luftuar abuzimet dhe për të krijuar një klimë sa më të favorshme biznesore. "Megjithatë, kemi ende shumë punë për të bërë dhe nuk do të ndalemi.

Konkurrenca e lirë dhe e ndershme është parakusht për konsolidimin dhe zgjerimin e bizneseve private si 'Lona Al Plast'. Prandaj, ne do ta luftojmë çdo formë abuzimi apo korrupsioni që e pengon konkurrencën e lirë. Po ashtu, do t'i vazhdojmë reformat që eliminojnë burokracitë dhe lehtësojnë barrën fiskale, në mënyrë që sektori privat të zhvillohet dhe të krijojë sa më shumë vende pune", ka deklaruar Veseli.

Katër subjektet më të fuqishme politike pëlqejnë të garojnë ndaras në zgjedhjet parlamentare, por ende nuk është

Nuk përjashtohen koalicioni



Njohësit e rrethanave politike në vend, Shkëlzen Maliqi dhe Imer Mushkolaj, kanë folur për mundësinë e koalicioneve parazgjedhore në minutat e fundit. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se lidhja e koalicioneve parazgjedhore në minutat e fundit është e mundshme. Maliqi dhe Mushkolaj kanë vlerësuar se skenari i vitit 2017, ku në ditën e fundit u nënshkruan dy koalicione parazgjedhore, mund ta nxisë sërish çdo lëvizje të partive politike nga blloqet aktuale politike. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që afati i fundit për regjistrimin e koalicioneve parazgjedhore do të jetë data 30 gusht

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 28 GUSHT - Njohësit e rrethanave politike në vend nuk e kanë përjashtuar mundësinë e përsëritjes së skenarit të koalicioneve të minutës së fundit. Ata kanë paralajmëruar se çdo lëvizje nga cilido bllok politik aktual do të provokonte lëvizje drejt koalicioneve të minutës së fundit sikurse ka ndodhur në vitin 2017.

Analisti Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se tani për tani duket se

LDK-ja, LV-ja, PDK-ja dhe koalicionet AAK-PSD e Nisma-AKR do të garojnë të vetme, por ka shtuar se ato u druhen koalicioneve të fundit. "Aktualisht duket sikur katër subjektet më të fuqishme preferojnë të garojnë ndaras, secila me shpresën se do të dalë subjekt më i votuar. Por, shëri sërish qëndron te mundësia e lidhjes së koalicioneve në çast të fundit. Andaj ditët e fundit LV-ja dhe LDK-ja përpiqeshin që të bënin koalicion të madh fitues, si koalicion të numrave, qoftë edhe me një program të përbashkët, jo

edhe aq parimor, vetëm që të mos përsëritet lançimi në mesnatë i afatit të një varianti të ri të koalicionit PAN, që do ta rifaktorizonte dhe mbante në pushtet PDK-në ku, p. sh., kjo tani nuk do të arrihej përmes Ramush Haradinajt, por Fatmir Limajt", ka deklaruar Maliqi.

Ai ka bërë me dije se këto subjekte janë të vetëdijshme se rivalët politikë mund të bëjnë koalicion në minutën e fundit. "Ky rrezik edhe i ka bërë tepër vigjilentë Isa Mustafën dhe Albin Kurtin, për ta gjetur formulën e koalicionit

të madh LDK-LV, i bazuar në ndarjen e pushtetit ekzekutiv, pushtet ky që do të mund të arrihej pothuajse pa problem, nëse koalicioni do të ishte parazgjedhor. Nëse LDK-ja dhe LV-ja, megjithatë, nuk e gjejnë formulën për kompromis programor, mbetet edhe opsion tjetër, që një prej subjekteve, LDK-ja ose LV-ja, të heqë dorë nga posti i kryeministrit, që nga të dyja palët do të përjetohej si dorëzim vullnetar i primatit, një vendim që i ngjan gëlltitjes së bretkosës", ka deklaruar ai, duke treguar se kush do të mund të hiqte dorë nga posti i kryeministrit. "Një tërheqje të tillë taktike-strategjike, sipas meje, më parë do të mund ta bënte LV-ja për shkak se struktura e saj është më autokratike, mundëson që për këtë akt të vendosë vetë Albin Kurti pa e dëmtuar shumë autoritetin e vet. Do të ishte një gjest që kuptohet si investim strategjik për të ardhmen", është shprehur ai.

Edhe analisti tjetër politik Imer Mushkolaj ka bërë me dije se

mund të befasohemi me koalicione të reja në çastin e fundit. "Skena politike në Kosovë zakonisht di të servojë befasi në çastet e fundit. Nuk përjashtohet mundësia e koalicioneve të tilla, por ndryshe nga herët e kaluara, kësaj here partitë janë përcaktuar më herët se kush me kë do të garojë", ka deklaruar Mushkolaj për "Epokën e re". Sipas tij, lëvizjet nga blloqet aktuale politike do të nxisnin koalicione në minutën e fundit. "Rreshtimet e deritashme paralajmërojnë një garë interesante dhe të paqartë deri në fund. Çdo lëvizje, nga cilido bllok politik aktual, do të provokonte lëvizje drejt koalicioneve të minutës së fundit", ka thënë Mushkolaj.

Në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 në çastet e fundit të afatit patën ndodhur lidhja e dy koalicioneve parazgjedhore. Koalicioni parazgjedhor mes LDK-së dhe AKR-së kishte nxitur regjistrimin e koalicionit mes PDK-së, AAK-së dhe Nismës (PAN) pesë minuta para skadimit të afatit ligjor për regjistrimin e

përfundimtare nëse do të ndodhë kështu

onet e minutës së fundit

Pesë kandidatë për kryeministër

Nëse subjektet politike nuk lëvizin në drejtim të ndonjë koalicioni të ri deri të premten në mesnatë, kur edhe është afati i fundit për regjistrimin e koalicioneve, atëherë për zgjedhjet e 6 tetorit Kosova do të ketë pesë kandidatë për

kryeministër, një femër dhe katër meshkuj.

Kandidate për kryeministër të LDK-së do të jetë Vjosa Osmani, femra më e votuar e legjislaturës së kaluar. Kandidat i PDK-së për kryeministër do të jetë lideri i kësaj

partie, Kadri Veseli, kurse Lëvizja Vetëvendosje, ndonëse ende nuk e ka zyrtarizuar, kandidat i kësaj partie do të jetë Albin Kurti.

Edhe dy koalicionet e deritashme parazgjedhore i kanë prezantuar kandidatët për

kryeministër për zgjedhjet e 6 tetorit. Për koalicionin AAK-PSD kandidat për kryeministër do të jetë Ramush Haradinaj, kurse kandidat i koalicionit Nisma-AKR për kryeministër do të jetë Fatmir Limaj.

ndonëse kanë pranuar se ende janë në negociata për ndonjë koalicion të mundshëm.

Anëtari i Kryesisë i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Xhelal Sveçla, ka thënë se veprimet e fundit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë treguar se nuk dëshirojnë koalicion parazgjedhor me Vetëvendosjen. Ai e ka quajtur tinëzar vendimin e LDK-së për ta kandiduar Vjosa Osmanin për kryeministër. "Vetëvendosja bëri maksimumin, duke mos paragjykuar as emrin e kandidatit për kryeministër, në mënyrë që gjithçka të vendosej së bashku nga LV-ja e LDK-ja, por me vendimin e pakoordinuar dhe tinëzar për të nxjerrë kandidat për kryeministër, LDK-ja tregoi se nuk dëshiron koalicion parazgjedhor", ka shkruar Sveçla në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ka thënë se liderët e dy partive janë duke punuar që të krijohet një koalicion parazgjedhor me Lëvizjen Vetëvendosje. Sipas tij, LDK-ja tashmë e ka vendosur që, me apo pa LV-në, posti i kryeministrit nuk do të negociohet.

Haziri u ka bërë thirrje zyrtarëve të partive që të përmbahen me deklaratat e tyre dhe t'u a lënë këtë punë liderëve të partive që ta negociojnë. "Është një format që ne kemi filluar ta bisedojmë në nivelin e liderëve. Unë dhe Osmani e mbështesim arritjen e një marrëveshjeje politike. E kemi vullnetin dhe dëshirën. Unë do të apeloja që të jemi të përmbajtur nga deklaratime të tilla. Është proces të cilin liderët po e dërgojnë drejt zgjidhjes më të mirë për qytetarët", ka deklaruar Haziri.

Veseli: Ministrat e PDK-së kanë dhënë shembuj në luftën kundër korrupsionit

PRISHTINE, 29 GUSHT (ER) - Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka thënë se ministrat e kësaj partie kanë dhënë shembuj për luftimin e korrupsionit në institucionet publike.

Veseli ka se duke e luftuar korrupsionin, siç e ka luftuar ministri i Financave, Bedri Hamza, mund ta ndërtojë një ekonomi më të ndershme e konkurruese. "Ka shumë shembuj që ministrat e PDK-së i kanë ndërmarrë

reformat më të thella kundër korrupsionit, duke kursyer para dhe investuar në mundësi të reja për të rinjtë tanë, për qytetarët tanë. Edhe Administrata Tatimore e Kosovës e dëshmon këtë, me masa konkrete që kanë pasur ndikim të matshëm dhe të prekshëm. Duke e luftuar korrupsionin, siç e ka luftuar ministri Bedri Hamza, ne mund ta ndërtojmë një ekonomi më të ndershme e konkurruese, me të zhvilluar dhe me mundësi më të

mëdha për ndërmarrësit tanë", ka thënë Veseli.

Përpos Hamzës, në Qeverinë Haradinaj nga radhët e PDK-së kanë qenë edhe këta ministra: Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë Kujtim Gashi, ministër i Kulturës, Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, Besim Beqaj e Muzafer Shala, ministra të Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

partive dhe koalicioneve parazgjedhore. KQZ-ja ka vendosur që afati për deklarimin e koalicioneve parazgjedhore do të jetë deri në orën 00:00 të datës 30 gusht.

Posti i kryeministrit po pamundëson koalicionin LDK - LV

Gjasat e një koalicioni LDK - LV janë zvogëluar së fundi shkaku i kandidaturës së Vjosa Osmanit për kryeministër nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Këtë e kanë konfirmuar zyrtarët e lartë të dy partive,



28 fëmijë me probleme në zemër po trajtohen në QKUK nga kardiokirurgët amerikanë

Prishtinë, 29 gusht (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se 28 fëmijë me probleme në zemër po trajtohen në Qendrën Klinike Universitare

të Kosovës (QKUK) nga kardiokirurgët amerikanë. Ai ka thënë se me ekipin nga ShBA-ja u pajtuan t'i rrisin kapacitetet vendore që këta fëmijë t'i trajtojnë në Kosovë. Ministri Ismaili

ka falënderuar organizatën "Gift Of Life" dhe klubin "Rotarian Prishtina" që bënë të mundur, që këtyre 28 fëmijëve t'u japim mundësi për një jetë të lumtur dhe të shëndetshme.



Daka: KQZ-ja nuk merr asnjë veprim pa ndarjen e buxhetit

PRISHTINË, 29 GUSHT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk mund të fillojë asnjë procedurë për organizimin e zgjedhjeve pa alokimin e parave të nevojshme nga qeveria në largim e Republikës së Kosovës. Kështu ka deklaruar për "Radion Evropë e Lirë", kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, e cila tha se KQZ-ja menjëherë, një ditë pas shpalljes së datës zyrtare të zgjedhjeve, ka bërë kërkesë zyrtare për alokimin e parave të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit.

Ndërkaq në rast të vonesave eventuale, KQZ-ja, sipas saj, nuk merr ndonjë përgjegjësi për mbarëvajtje të mirë të zgjedhjeve. "KQZ-ja nuk mund të ndërmarrë asnjë hap pa i pasur paratë e alokuara. KQZ-ja nuk mund të marrë përgjegjësi për vonesa, për mosmbarëvajtje të zgjedhjeve. Sepse ne që në ditën e parë dhe që nga momenti kur kryeministri ka dhënë dorëheqje, kemi treguar se meqë (2019) nuk ka qenë vit zgjedhor, KQZ nuk ka mjete për organizimin e zgjedhjeve", ka thënë Daka.

Buxheti i planifikuar për organizimin dhe mbajtjen e procesit zgjedhor llogaritet të jetë rreth 6 milionë euro. Ministri në largim i Financave në Qeverinë e Kosovës, Bedri Hamza, ka thënë për "Radion Evropë e Lirë" se të gjitha paratë e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve ekzistojnë, por që nuk mund të



barten pa sqarimet juridike. Hezitimi i Ministrisë së Financave, që t'i alokojë mjetet e nevojshme KQZ-së, ndërlidhet me kërkesën që kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, i ka drejtuar Gjykatës Kushtetuese me të cilën ka kërkuar interpretimin e funksioneve të qeverisë pas dorëheqjes së tij. Përderisa nuk ka ende një aktgjykim apo vendim të Gjykatës Kushtetuese, Ministria e Financave nuk po i ndan KQZ-së buxhetin e nevojshëm për zgjedhjet e 6 tetorit. "Unë besoj se Kushtetuesja duhet të

bëjë veprime në kompetencën e saj. Pa u lëshuar në çështjet, detyrat dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, ne do të presim të sqarohet kjo situatë dhe pas sqarimit të situatës, t'i ndërmarrim veprimet e nevojshme në përputhje me ligjin", tha ministri Hamza. Sipas tij, sapo që Kushtetuesja ta japë vendimin apo interpretimin, hiqen të gjitha pengesat që buxheti për zgjedhje t'i alokohet KQZ-së. "Pra, shumica e mjeteve nuk është problem, mjetet ekzistojnë, janë në buxhet, Ligji për buxhetin e autorizon

Ministrinë e Financave t'i realizojë këto transferime, por vetëm kemi nevojë të sqarohet situata juridike në mënyrë që të merren veprimet e nevojshme", ka thënë Hamza. Ndërsa Valdete Daka thotë se përderisa qeveria pret vendimin e Gjykatës Kushtetuese për ndarjen e buxhetit, edhe KQZ-ja nuk mund të marrë asnjë veprim organizativ. "Ne nuk mund të angazhohim një operator i cili do ta bëjë informimin publik dhe informimin e qytetarëve lidhur me mënyrën e votimit, nuk

mund të porositim asnjë mjet apo material zgjedhor, qoftë sensitiv, qoftë josensitiv. Aty hyjnë fletëvotimet, llambat e materiale të tjera. Pra, të gjitha materialet të cilat ne nuk i mbajmë rezervë, pasi që ne nuk e dimë kur mbahen zgjedhjet, përveç zgjedhjeve të rregullta", shprehet Daka.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka afat ligjor prej 60 ditësh për t'i dhënë një përgjigje kërkesës së kryeministrit në dorëheqje, Ramush Haradinaj, i cili e ka deponuar kërkesën e tij në këtë Gjykatë më 29 korrik.

Ministri Bytyqi kërkoi zbatimin e vendimit për rritjen e numrit të studentëve të rinj në mjekësi

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë në largim, Shyqiri Bytyqi, ka pritur në takim anëtarin e Këshillit Drejtues të UP-së, Ujkan Bajra, prorektorët Hysen Bytyqi dhe Merita Koçnaj-Berisha, si dhe dekanen e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka. Gjatë këtij takimi u bisedua lidhur me situatën e krijuar për regjistrimin e studentëve në Fakultetin e Mjekësisë për vitin e ri akademik 2019/2020.

Ministri Bytyqi ka thënë se UP-ja, përkatësisht Fakulteti i Mjekësisë, sa më parë duhet të zbatojë vendimin e MASHT-it lidhur me rritjen e numrit të studentëve të rinj në dy drejtime



të këtij fakulteti. Po ashtu, Bytyqi ka thënë se vendimi për rritjen e numrit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë, përkatësisht drejtimet Mjekësi e Përgjithshme dhe Infermieri, është marrë në bazë të kërkesës së UP-së.

Sipas ministrit Bytyqi, një vendim i tillë është marrë në bazë të kompetencave ligjore që ka ministria, por edhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, duke e konsideruar si politikë arsimore me interes kombëtar.

Ministri Bytyqi ka kërkuar që sa më parë të fillojë së zbatuari vendimi, ndërsa përfaqësuesit e UP-së dhe të FM-së u shprehën të gatshëm ta respektojnë vendimin e MASHT-it siç është paraparë në vendim.

Partitë politike përqendrohen në aderime

Subjektet politike këto ditë janë përqendruar shumë në prurje të reja. Përveç fushatës në terren, shumica e partive dhe koalicioneve parazgjedhore rëndësi të madhe janë duke u kushtuar edhe aderimeve. Lëvizje në këtë drejtim ka pasur edhe të mërkurën. PDK-së i është bashkuar aktivisti i hershëm i çështjes kombëtare dhe afaristi Nexhmedin Muçiqi. Në Lëvizjen Vetëvendosje (LV) ka aderuar Funda Demiri. Ndërkaq, pjesë e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) është bërë doktori i Logjikës dhe filozofisë analitike, Mustafa Bajrami

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 28 GUSHT - Krahas fushatës në terren, këto ditë koalicionet parazgjedhore dhe partitë politike janë duke investuar edhe në prurjet e reja. Përveç kalimit të zyrtarëve nga një parti në tjetrën, partitë afër vetes po synojnë të marrin profesionistë të fushave të ndryshme. Edhe gjatë ditës së mërkurë ka pasur lëvizje sa iu përket aderimeve.

Aktivisti i hershëm i çështjes kombëtare dhe afaristi Nexhmedin Muçiqi i është bashkuar të mërkurën Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se kjo parti është e përkushtuar që të punojë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të rinjtë dhe kontributi i Muçiqit si aktivist dhe i çdo qytetari është i mirëseardhur. "Nexhmi Muçiqi është anëtar i ri i Partisë Demokratike të Kosovës. Ai është aktivist i hershëm i çështjes kombëtare dhe biznesmen i suksesshëm. Partia Demokratike e Kosovës është e përkushtuar të punojë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të rinjtë tanë dhe kontributi i Nexhmiut si aktivist dhe i çdo qytetari është i mirëseardhur", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa Lëvizjes Vetëvendosje (LV) i është bashkuar Funda Demiri, e cila ka lindur në Finlandë. Lideri i kësaj lëvizje, Albin Kurti, ka thënë se inkadrimi i Demirit në Vetëvendosje është vlerë e çmuar. Ai ka deklaruar se Vetëvendosja është lëvizje e rinisë dhe, sipas tij, Funda ka kurajë për të kontribuar në LV. "Nga Finlanda në Vetëvendosje! Funda Demiri, e lindur në Finlandë, është 20-vjeçare. Ka studiuar në drejtimin e Punëve Sociale dhe Shëndetësore, Dega e Shëndetit Mendor dhe Njerëzve të Varur nga Substancat Narkotike dhe Alkoolike. Në periudhën e studimeve, sa ishte 16-vjeçare, Funda filloi angazhimin si aktiviste vullnetare në partinë e majtë Vasemmistolliito. Aty u angazhua në Departamentin e të Rinjve. Më vonë, në vitin 2017, ajo fillon pjesëmarrjen aktive në poli-

tikë, tashmë duke garuar. Në atë garë doli fitimtare duke u zgjedhur asambleiste në Komunën Vantaa të kryeqytetit Helsinki, aty ku tashmë jeton dhe vepron. Dua ta ndërtoj një qytet të mirë, të barabartë e jo përjashtues në bazë të gjendjes ekonomike, racore, shëndetësore a shoqërore dhe me mundësi për të gjithë të rinjtë në Vantaa, kështu më tha Funda. E gjithë ky aktivizëm është vlerë e çmuar. Shto këtu kurajën e madhe që ka Funda për të kontribuar në Lëvizje. Kjo edhe është Lëvizja. Lëvizje e rinisë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Aderimet të mërkurën kanë vazhduar edhe në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Partisë së Ramush Haradinajt i është bashkuar doktori i logjikës dhe filozofisë analitike, Mustafa Bajrami. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se projekti i Aleancës 100 për qind shtet është duke marrë mbështetje të madhe këto ditë. "Interesimi i jashtëzakonshëm i profesionistëve të fushave të ndryshme për ta mbështetur projektin e Aleancës 100 për qind shtet dëshmon qartë besimin në vlerat tona. Sot zyrtarisht rrugëtimit tonë politik iu bashkua Mustafa Bajrami, doktor i logjikës dhe filozofisë analitike. Ai studimet bachelor i përfundoi në Egjipt, ndërsa studimet master dhe doktoraturën në Turqi. Mirënjohës për besimin dhe njëkohësisht shpreh konsideratën time për familjen dhe babanë e tij, H. Jetish Bajrami, ish-kryetar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, myfti i Kosovës, i cili gëzon respekt të madh nga të gjithë", ka deklaruar Haradinaj.

Zyrtarisht fushata zgjedhore e partive politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare e 6 tetorit do të jetë dhjetë ditë. Fushata do të fillojë më 25 shtator dhe do të përfundojë më 4 tetor.

Kurse deklarimi për koalicione parazgjedhore nga ana e subjekteve politike fillon më 27 gusht dhe përfundon më 30 gusht. Ndërsa afati për regjistrimin e votuesve jashtë vendit do të jetë i hapur nga data 30 gusht deri më 10 shtator. Rreth 6 milionë euro pritet të kushtojë organizimi i zgjedhjeve të parakohshme të 6 tetorit.



PD-ja i bashkohet koalicionit Nisma - AKR

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Partia e Drejtësisë (PD) përmes një komunikate për media ka njoftuar se, pas bisedimeve gjithëpërfshirëse me presidentin e AKR-së, Behgjet Pacolli dhe në vazhden e bashkëpunimit të frytshëm politik shumëvjeçar të Partisë së Drejtësisë me Aleancën Kosova e Re, është arritur marrëveshja për koalicion parazgjedhor ndërmjet

PD-së dhe AKR-së. "Ky koalicion parazgjedhor do të fuqizojë në mënyrë përmbajtësore koalicionin tani më të arritur ndërmjet subjekteve politike AKR dhe Nisma dhe do të paraqesë alternativë të besueshme dhe vizionare për qytetarët e Republikës së Kosovës në periudhën tejet të ndjeshme për të ardhmen e ven-

dit", thuhet në këtë komunikatë. "Partia e Drejtësisë fton gjithë elektoratin e saj që të mbështetë këtë koalicion parazgjedhor në funksion të promovimit dhe institucionalizimit të vlerave të dëshmuara të traditës sonë kombëtare dhe qytetare euroatlantike në politikën e qeverisë së re të vendit", është theksuar në komunikatën e PD-së.

Disa përfaqësues serbë krijojnë koalicion parazgjedhor

PRISHTINË, 29 GUSHT - Disa përfaqësues të serbëve të Kosovës kanë nënshkruar të mërkurën koalicion parazgjedhor për zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 6 tetor. Marrëveshja është nënshkruar nga Nenad Rashiq, Partia Përparimtare Demokratike, Rada Trajković nga Lëvizja Evropiane e serbëve në Kosovë, Dragisha Miriqi, Partia e Re e Kosovës dhe Branislav Marković.

Në deklaratën e përbashkët të këtyre subjekteve politike thuhet se qëllimi i tyre më i



rëndësishëm, strategjik dhe politik, do të jetë ruajtja dhe forcimi i serbëve të Kosovës në

atë mënyrë që do të siguronte mbijetesë të qëndrueshme. "Qëllimi ynë afatgjatë është të

krijojmë kushte të mira jetese për serbët, zhvillimin e tyre shoqëror, politik, institucional dhe ekonomik. Ne jemi dëshmitarë të apatisë absolute të rinjtë serbë, të cilët, për shkak të veprimeve të dobëta politike të përfaqësuesve aktualë, nuk shohin ndonjë perspektivë të mëtejshme në Kosovë dhe gjithnjë e më shumë po zgjedhin ta jetojnë jetën e tyre diku tjetër", është thënë në deklaratën e përbashkët, raporton "Rel".

Përveç kësaj, në deklaratë është thënë edhe se këto subjekte do të jenë të hapura për çdo bised-

im që synon, siç është thënë, forcimin e "zërit të serbëve të Kosovës" dhe vendosjen e shtyllave të një kthimi të sigurt të serbëve të zhvendosur.

Zgjedhjet e parakohshme në Kosovë do të mbahen më 6 tetor.

Deri më tash komuniteti serb është përfaqësuar në institucionet e Kosovës kryesisht përmes Listës Serbe, partia e vetme që gëzon mbështetjen nga Beogradi zyrtar. Në Kuvendin e Kosovës kjo parti ka pasur 9 prej 10 deputetëve serbë.

'Katalogu i problemeve të Kamenicës', shkollat, transporti dhe rrugët, në gjendje të rëndë

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar katalogun e çështjeve për Komunën e Kamenicës, që përfshinë problemet me të cilat përballen qytetarët dhe bën prioritizimin e disa çështjeve esenciale që duhet të përfshihen në planifikimet buxhetore të komunave për vitin 2020.

Si rrjedhojë e një hulumtimi në terren, në këtë komunë janë identifikuar probleme në infrastrukturën rrugore, rrjetin e kanalizimit, furnizimin me ujë të pijes, transportin publik, gjendjen e shkollave, menaxhimin e mbeturinave, ndriçimin publik dhe shërbimet shëndetësore. "Pothuajse të gjitha vendbanimet kanë nevojë për intervenim në infrastrukturën rrugore. Problemi me ujësjellës paraqitet si problem primar që ka nevojë për intervenim. Shumë fshatra si

Busvata, Krileva, Strezoci e fshatra të tjerë malorë shprehin shqetësimin e tyre rreth çështjes së ujit të pijes", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Sipas kësaj komunikate, gjendja jo e mirë e shkollave është shprehur në shumë lokalitete të Komunës së Kamenicës. "Prej 35 anketave të realizuara në 21 lokalitete (14 shkolla), banorët shprehin pakënaqësitë e tyre rreth gjendjes së shkollave. Komuna e Kamenicës, për shkak të territorit shumë të madh dhe popullsisë së shpërndarë, sigurimi i transportit, sipas banorëve, do ta lehtësonte jetën në fshatra të thellë, me ç'rast do ta zvogëlonte migrimin fshat-qytet", është theksuar në komunikatën e KDI-së.

Në ditën në vazhdim KDI-ja do ta publikojë katalogun e nëntë komunave të tjera të hulumtuara.



Policia arreston tetë persona të dyshuar për prostitucion

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Sektori i Hetimeve nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Njësia për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Prishtinë, pas hetimeve të zhvilluara, më 27 gusht kanë realizuar dy plane operative lidhur me veprat

penale 'mundësim ose detyrim në prostitucion', 'ofrim i lokaleve për prostitucion', si dhe 'bashkëkryerje'.

Gjatë realizimit të këtyre planeve operative në dy lokacione të ndryshme janë identifikuar dhe janë arrestuar persona të dyshuar të përfshirë në veprat penale të lartcekura. Në lokacionin e parë



gjatë realizimit të planit operativ janë arrestuar dy persona, ndërsa në lokacionin e dytë janë arrestuar gjashtë persona të dyshuar.

Lidhur me rastin si prova materiale janë sekuestruar shtatë telefona mobilë.

Pas intervistimit, me vendim të prokurorit, të dyshuarit janë ndaluar për 48 orë.

Në Qendrën e Paraburgimit në Pejë vetëvaret një i paraburgosur

PEJË, 28 GUSHT (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se në Qendrën e Paraburgimit në Pejë të mërkurën, gjatë hapjes së dhomave dhe numërimit të të burgosurve, në banjën e

njëres prej dhomave është gjetur i vetëvarur i paraburgosuri me inicialet B. GJ. Në dhomë bashkë me të ishin edhe tre persona të tjerë. I paraburgosuri ishte në mbajtje nga data 14. 06.

2019 dhe ishte i vendosur në Qendrën e Paraburgimit në Pejë. "Lidhur me rastin janë njoftuar Policia e Kosovës dhe prokurori, të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe po e hetojnë rastin.

Sapo të kemi një raport me të zgjeruar nga organet kompetente hetimore, do t'ju informojmë", është bërë me dije në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.



OEK-u, pjesë e Forumit Biznesor në Vjenë

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) do të jetë e pranishme në Forumin Biznesor që do të mbahet në Vjenë gjatë muajit tetor.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka takuar ambasadorin e Japonisë për Austri dhe Kosovë, Kiyoshi Koinuma. Gjatë këtij takimi Rukiqi ka theksuar rëndësinë e avancimit të bashkëpunimit ekonomik me Japoninë përmes aktiviteteve konkrete të cilat mundësojnë promovimin e Kosovës, si vend atraktiv për investime dhe në të njëjtën kohë shfaqin potencialin e kompanive të Kosovës për eksport të produkteve e shërbimeve. Rukiqi gjatë takimit ka pranuar

ftesën nga Koinuma për të qenë pjesëmarrës në Forumin Biznesor që do të mbahet në Vjenë gjatë muajit tetor ku, përveç të tjerash, do të kremtohet 10-vjetori i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në mes të Kosovës dhe Japonisë.

Në këtë forum do të marrin pjesë më shumë se 100 kompani japoneze të cilat do ta kenë rastin t'i dëgjojnë mundësitë dhe lehtësirat që Kosova ofron në të bërit biznes. Oda Ekonomike e Kosovës ka kënaqësinë të jetë e pranishme në këtë forum i cili, krahas thellimit të bashkëpunimit ekonomik, mundëson rrjetëzim me kompani prestigjioze japoneze.



ATK-ja, tatimpaguesve: Deklarojeni saktë tatimin

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) u ka bërë thirrje të gjithë personave të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar t'i deklarojnë tatimet dhe kontributet pensionale në mënyrë reale, në të kundërtën ATK-ja do të detyrohet të ndërmarrë masa ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 GUSHT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ua ka rikujtuar të gjithë personave të cilët merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar t'i deklarojnë tatimet dhe kontributet pensionale në mënyrë reale. "Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te kategoritë, si: nëndeklaruesit e pagave të punëtorëve, nëndeklaruesit të bizneset e mesme dhe të mëdha, nëndeklaruesit të bizneset mikro dhe të vogla, me

qëllim të identifikimit të atyre bizneseve, të cilat nëndeklarojnë të ardhurat e tyre", është thënë në njoftimin e ATK-së, duke u shtuar se disa nga veprimtaritë në vijim nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK-ja u bënë thirrje të deklarojnë apokorigojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe t'i përbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor. "Identifikimi i bizneseve, të cilat nëndeklarojnë pagat e punëtorëve; identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nëndeklarim, në veçanti veprimtaritë, si tregti, shërbime, ndërtime dhe prodhim;



identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nëndeklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht në kuotën fikse prej 37.50 eurosh në çdo tre muaj; identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nëndeklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht nën pragun e TVSh-së, veçanërisht bizneset në veprimtaritë, si tregti, shërbime profesionale,

zbavitëse-artistike, prodhim, transport etj.; identifikimi i bizneseve, të cilat operojnë me humbje, si dhe bizneseve që deklarojnë me zero; identifikimi i bizneseve të cilat ofrojnë furnizime pa të drejtën e kreditimit të TVSh-së, ndërsa në anën tjetër zbrasin TVSh-në në blerje; identifikimi i bizneseve të cilat importojnë apo tregtojnë mallra me akcizë, të cilët

përmes dokumentacionit jo të saktë, respektivisht nënvlerësimit të çmimeve të shitjes, iu shmangen detyrimeve tatimore; identifikimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e tekstilit dhe veshmbathjeve, të cilat mbajnë dokumentacione jo të sakta me qëllim të shmangies së detyrimeve tatimore etj., dhe identifikimi dhe trajtimi i personave të cilët nuk bëjnë deklarimin e të ardhurave të ndryshme që ata mund të kenë qoftë të hyrat nga jashtë vendit, të hyrat nga kapitali apo të hyrat e tjera", thuhet në njoftimin e ATK-së.

ATK-ja u bënë thirrje të gjithë personave të lartcekur që t'u përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK-ja do të detyrohet t'i ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

ATK-ja ka theksuar se me kryerjen e detyrimeve tatimore jepet kontribut në ofrimin e shërbimeve publike për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.

Në tre muajt e fundit ka rritje të kërkesave për shërbimet e Valës

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka thënë se ndihet i lumtur pasi produktet dhe shërbimet e Telekomit janë shfrytëzuar nga bashkatdhetarët dhe nga vizitorët e huaj brenda këtij sezoni veror. "Kjo dëshmohej më së miri nga të dhënat zyrtare të frekuentimit dhe shitjes, veçanërisht në pikën kryesore të Valës në Sheshin 'Nëna Tereza' në kryeqytet, ku vërehet rritje e konsiderueshme e kërkesave për shërbimet tona.

Në tre muajt e fundit, saktësisht për periudhën maj, qershor dhe korrik, qendra e biznesit Vala në Sheshin 'Nëna Tereza', rezultojnë se ka pasur ngritje të të hyrave mbi 28 për qind dhe ky trend pritet të vazhdojë edhe gjatë ditëve të fundit të muajit gusht. Jo vetëm në pikat e shitjes në Prishtinë, por edhe në të gjitha qendrat regjionale është vërejtur rritje e ndjeshme e shfrytëzimit të pakove të kombinuara me numrat PrePaid dhe PostPaid", ka thënë ai. Istrefi ka theksuar se për të

mirëpritur dhe për t'ua lehtësuar sidomos bashkatdhetarëve tanë qëndrimin në vendlindje, Vala ka organizuar kampanja speciale nëpër të gjitha qytetet e Kosovës dhe në pikat kufitare. "Gjatë këtij sezoni veror Vala ka ofruar oferta atraktive për të gjithë konsumatorët që kanë vizituar Kosovën apo që kanë pushuar në bregdetin shqiptar apo në vendet e regjionit duke shfrytëzuar shërbimet e telefonisë mobile dhe internetit të shpejtë", ka thënë Istrefi.



Haskuka shkarkon drejtorin e Arsimit

PRIZREN, 28 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka shkarkuar drejtorin Arsimit në këtë komunë, Gani Gërmizaj. Haskuka ka bërë me dije se vendimi për shkarkimin e tij është marrë për shkak të parregullsive në themelimin e komisioneve për konkurse të hapura pranë kësaj drejtorie. "Komisionet intervistuese, të themeluara me vendim të drejtorit, nuk

kanë qenë në përputhje me ligjin për shkak se, sipas Ligjit mbi arsimin parauniversitar dhe udhëzimin administrativ, ndër të tjera, në komisionet përzgjedhëse një nga anëtarët duhet të jetë drejtori i shkollës përkatëse. Ky është interpretimi ligjor nga Drejtoria e Inspektoratit të Arsimit dhe Departamenti Ligjor pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga të cilët kam kërkuar inter-

pretim ligjor si pasojë e shumë ankesave që kam pranuar lidhur me konkurset e fundit. Nga drejtori kam kërkuar që t'i respektojë rregullat që burojnë nga ligjet, në mënyrë që të kemi një proces të drejtë dhe të ligjshëm për përzgjedhjen e mësimdhënësve. Përkundër kërkesës sime, ai nuk ka ndërmarrë këtë veprim, andaj me keqardhje më është dashur ta ndërmarr masën e fundit,

shkarkimin e tij", ka thënë Haskuka.

Ai ka pohuar se sistemi i arsimit për shkak të gjendjes së keqe kërkon më shumë angazhim. "Sistemin e arsimit të cilin e kemi trashëguar ka qenë në gjendje të keqe, që kërkon shumë angazhim dhe punë prej të gjithë aktorëve në mënyrë që fëmijëve tanë t'u ofrojmë shkollim cilësor. Prandaj së shpejti do ta kërkoj formimin e komisioneve të



reja, në mënyrë që të kemi një proces të mirëfilltë në përzgjedhjen e mësimdhënësve. Si kryetar unë do ta bëj të pamundurën që arsimin ta kthejmë në binarë të zhvillimit", ka thënë Haskuka.

Rapperswili nga Zvicra forcon bashkëpunimin me Skenderajn

SKENDERAJ, 28 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim kryetarin e komunës Rapperswil-Jona të Zvicrës, Martin Stokling, i cili ka qenë i shoqëruar nga Hans-Jorg Goldener, menaxher i Kuvendit Komunal, Naim Zeqiri, këshilltar i kryetarit Stokling, Visar Rrecaj, konsull në Konsullatën në Cyrih dhe Akenbut Iballi, kryetar i OJQ "ProKosova" në Zvicër.

Jashari ka njoftuar homologun e vet për vizitat e realizuara dhe për qëllimin e këtij takimi në Skenderaj. "Një mirëseardhje miqësore dhe të ngrohtë për mikun tim, Martin Stokling, kryetar i komunës Rapperswil-Jona të Zvicrës. Gjatë vizitës në qytetin tonë, që nisi me homazhe te varri i komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të

Kosovës, Adem Jashari në Prekaz, për ta dëgjuar nga afër historinë e luftës së Jasharëve. Kemi vizituar më pas fabrikat në komunën tonë, si: qumështoren 'Drena', 'Vëllezërit Geci', 'Grunorin', Shkollën Profesionale, Shërbimin e Zjarrfikësve dhe Shpëtimin dhe "Muli Shoes", për t'u njohur për së afërmi me kapacitetin e këtyre fabrikave, numrin e punëtorëve, linjat e prodhimit, shitjen, kushtet dhe gjithçka tjetër që lidhet me punën e tyre", ka thënë Jashari.

Ky ka qenë takimi i dytë pas vizitës së Jasharit vitin e kaluar në komunën Rapperswil-Jona dhe e gjithë kjo po bëhet me qëllim të realizimit të mundësisë së bashkëpunimit nëpërmjet projekteve konkrete për qytetarët e Komunës së Skenderajt.



Së shpejti pritet të funksionalizohet rrjeti i ujësjellësit në fshatin Zasellë të Mitrovicës



MITROVICË, 28 GUSHT (ER) - Në kuadër të prioriteteve për përmirësimin e jetës së qytetarëve, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë (DShPI) ka filluar ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Zasellë të Mitrovicës.

Komuna e Mitrovicës këtë projekt e ka filluar në vitin 2009, mirëpo meqenëse në realizimin e tij janë hasur disa vështirësi, punimet kanë ngecur deri më tani, me ç'rast drejtori Muja bëri përpjekje të shumta që ky projekt të implementohet sa më parë. Vështirësi të shumta ka hasur edhe drejtori i DShPI-së, Naser

Muja, pasi gati dy vjet kanë zgjatur procedurat për pëlqimin nga ana e KEDS-it lidhur me sigurimin e pompave dhe trafos së re elektrike, në mënyrë që t'i mbulojë të gjitha kapacitetet e mjaftueshme për furnizim me energji elektrike për banorët e këtij fshati. Me këtë rast, drejtori Muja ka marrë pjesë në testimin e fazës finale të funksionalizimit të ujësjellësit në këtë fshat, i cili ka folur për rëndësinë e madhe që ka ky projekt për banorët e kësaj ane. "Punimet për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit kanë filluar para tri javësh dhe deri më tani janë kryer me një ritëm

mjaft të lartë, prandaj jam shumë i lumtur që kemi arritur të bëjmë të realizueshëm këtë projekt, përmes të cilit pritet shumë shpejt të zgjidhet problemi i ujit të pijes për banorët e këtij fshati", është shprehur Muja.

Gjithashtu, këto rrjete do të kalojnë për mirëmbajtje nën menaxhimin e Kompanisë Rajonale të Ujësllësit "Mitrovica" Sh. A. dhe në kuadër të këtij projekti do të vendosen edhe orëmatësit në amvisëri, e keqpërdorimi i ujit nga ana e qytetarëve do të jetë i pamundur.


Uji nga 'Hidromorava' në Kamenicë mund të përdoret vetëm për sanitari

Kamenicë, 28 gusht (ER) - Komuna e Kamenicës ka bërë me dije se kompania rajonale e ujësjellësit "Hidromorava" ka kryer dezinfektimin e rezervuarit dhe gjitha gypave të ujësjellësit

në këtë komunë. Me këtë rast, kjo komunë ka theksuar se uji nga ky ujësjellës mund të përdoret vetëm për sanitari. "Ju njoftojmë se pas marrjes së mostrave të para, uji mund të

përdoret vetëm për sanitari dhe nevoja të tjera, por assesi për pije. Tani jemi në fazën e pritjes së rezultateve përfundimtare nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, për të

parë nëse mund të shfrytëzohet edhe për pije. Lusim qytetarët që deri në njoftimin e radhës ta evitojnë ujin për pije", është thënë në njoftimin e Komunës së Kamenicës.



Zgjedhjet 2019: A do ta gëlltitë kush bretkosën?



Shkëlzen MALIQI

Për zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen më 6 tetor partitë politike tashmë kanë filluar përgatitjet dhe po krijohen koalicionet parazgjedhore që do ta përcaktojnë natyrën e garës. Këtë herë gara do të jetë, me gjasë, më ndryshe nga zgjedhjet e viteve 2013 dhe 2017. Pritet që ato të janë më rezultative, në kuptimin se vota nuk do të shpërndahet duke krijuar ngushtica që pengonin arritjen e mazhorancës dhe bllokunin punën e Kuvendit dhe të ekzekutivit. Në zgjedhjet e 6 tetorit pritet se subjektet politike shqiptare do të krijojnë mazhorancë të konsiderueshme për të bërë qeveri stabile pa e kërkuar mbështetjen shantazhuese të Listës serbe. Këtë konstatim e mbështes në rezultatet e sondazheve që janë bërë kohën e fundit (nuk i kam bërë vetë, janë të organizatave të tjera), si dhe në analizën e koalicioneve parazgjedhore tashmë të shpallura dhe atyre që po negociohen me qëllimin që të evitohen bllokadat si ato që në pesë vjetët e fundit kanë ndikuar negativisht në qeverisje dhe zhvillimin e Kosovës. Ndonëse materialet e sondazheve që i kisha në disponim nuk i konsideroj për burime absolutisht të sakta, (në to kam gjetur elemente kontradiktore dhe dyshime për "favorizime" dhe "disfavorizime" të subjekteve të caktuara politike), megjithatë, kam hetuar disa elemente të ngjashmëri që japin mundësi për konkludim

se te elektorati i Kosovës po shfaqet trendi që sinjalizon rezultatin përmbyesës më 6 tetor.

Hipoteza e parë për trendin është se në zgjedhjet e 6 tetorit, ndër subjektet politike shqiptare, do ta kemi garën e pesë grupimeve që pak a shumë janë të formësuar, ndonëse ka edhe mundësi që ato të ngjeshën ose të rigrupohen në dy ditët e ardhshme para përfundimit të afatit për paraqitjen e tyre në KQZ. Këto subjekte janë: LDK, LV, PDK, AAK + PSD dhe Nisma + AKR.

Katër subjektet e para, si parti me vete, ose të sforcuara me partnerë (parti të vogla me të cilat janë lidhur në koalicion), mund të garojnë duke llogaritur se secili subjekt gëzon përkrahjen e rreth 20 deri në 22 për qind të elektoratit të përgjithshëm shqiptar. Ndërkaq, subjekti i pestë, Nisma + AKR-ja, me gjasë e ka përkrahjen e 8 deri në 9 për qind të elektoratit.

Kjo vlerë e katër subjekteve me përkrahje prej 20-22 përqindësh të elektoratit është një rumbullakim i përafërt, ku më 6 tetor do të mund të ketë diferenca me plus ose minus prej 1 deri 1,5 përqindësh ndaj vlerës të parë aproksimative. Kjo do të thotë se, po e them këtë spekulativisht, LDK-ja më 6 tetor mund të dalë me 21 deri në 23 për qind, kurse AAK + PSD-ja të fitojë, p. sh., 17 ose 18 për qind. Po kështu, mund të dalin vlera të përmbyesura, LDK-ja me më pak se 20 për qind, kurse tjetri subjekt, me mbi 20 për qind.

Poenta e këtij argumenti është se këto pesë subjekte do ta ndajnë 90 deri në 92 për qind të votave të shqiptarëve, duke dhënë përqindjet më të koncentruara dhe njëkohësisht edhe më decidive për arritjen e mazhorancës optimale për qeverisje e jo si më parë, afër

pragut kritik të mazhorancës, ose nën të, që pastaj krijonte varësinë nga Lista serbe, qëllimet e së cilës kanë qenë destruktive ose shantazhuese të dirigjuara nga Beogradi.

Në kushtet më normale politike, ku nuk do të ekzistonin vijat e kuqe të bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes mes subjekteve me interesa dhe programe të ndryshme politike, partitë garuese që vlerësojnë dhe besojnë se mund të fitojnë dhe të dalin të parat duke garuar si të vetme në zgjedhjet, edhe çështja e koalicioneve do të mund të lihej për më vonë, pasi që të kryhen zgjedhjet. Por kjo te na nuk ndodh sepse partitë tona e kanë frikën nga gabimi si ai në zgjedhjet e fundit kur fatin e tyre e përcaktuan dy koalicionet e bëra më nguti dhe ad hoc: njëra një ditë para afatit ligjor mes LDK-së dhe AKR-në, tjetra 5 minuta para skadimit të afatit për regjistrim mes PDK-së, AAK-së dhe Nismës (koalicioni PAN).

Kjo histori se si koalicioni PAN me dredhi ia hodhi LDK-së dhe AKR-së për të dalë subjekti më i votuar, dhe pastaj e grabiti ose bleu AKR-në për t'i bërë votat e mazhorancës minimale për qeverisje, edhe tani ka ndikim në tensionimin e momentit kritik të regjistrimit të subjekteve garuese në KQZ, sepse në dy ditët e ardhshme, më 28 dhe 29 gusht, mund të përsëritet skenari i koalicioneve të fundit.

Aktualisht duket sikur katër subjektet më të fuqishme preferojnë të garojnë ndaras, secila me shpresën se do të dalë subjekt më i votuar. Por, shëri sërish qëndron te mundësia e lidhjes së koalicioneve në moment të fundit. Andaj në ditët e fundit LV-ja dhe LDK-ja përpiqeshin që të bënin koalicion të madh fitues, si koalicion të numrave" qoftë edhe me një "program" të përbashkët jo edhe aq parimor, vetëm që të

mos përsëritet lançimi në mesnatë i afatit të një varianti të ri të koalicionit PAN, që do ta rifaktorizonte dhe mbante në pushtet PDK-në ku, p. sh., kjo tani nuk do të arrihej përmes Ramush Haradinajt, por Fatmir Limajt.

Ky rrezik edhe i ka bërë tepër vigjilentë Isa Mustafën dhe Albin Kurtin, për ta gjetur formulën e koalicionit të madh LDK - LV, i bazuar në ndarjen e pushtetit ekzekutiv, pushtet ky që do të mund të arrihej pothuajse pa problem, nëse koalicioni do të ishte parazgjedhor.

Nëse LDK-ja dhe LV-ja, megjithatë, nuk e gjejnë formulën për kompromis programor, mbetet edhe opsion tjetër që njëri prej subjekteve, LDK-ja ose LV-ja, të heqë dorë nga posti i kryeministrit, që nga të dyja palët do të përjetohej si dorëzim vullnetar i primatit, një vendim që i ngjanë gëlltitjes së bretkosës.

Një tërheqje të tillë taktike-strategjike, sipas meje, më parë do të mund ta bënte LV-ja për shkak se struktura e saj është më autokratike, mundëson që për këtë akt të vendosë vetë Albin Kurti pa e dëmtuar shumë autoritetin e vet. Do të ishte një gjest që kuptohet si investim strategjik për të ardhmen.

A është kjo reale? Mbase është tepër të pritët gjest i tillë nga Kurti. Me gjasë ai nuk ka nxjerrë mësim nga përvoja e çarjes me Shpend Ahmetin dhe fraksionin e LV-së që kaloi te PSD-ja, sepse edhe në këtë rast molla e shërit ka qenë posti i kryeministrit. Kurti me përkrahësit e vet kanë prirje që të fiksohen te simbolika e thjeshtëzuar e postit të kryeministrit, e jo te procesi politik dhe autoriteti dhe pushteti real nuk shkon gjithnjë me postin, por me liderin dhe bartësin e ideve dhe projekteve. LDK-ja, ndërkaq, në këtë fazë, kur si parti nuk është e kon-

soliduar mjaftueshëm, sepse në proceset e fundit ka hasur në shumë vështirësi në bartjen e kompetencave tek brezat më të ri të politikanëve, gjithësesi e ka shumë më vështirë ta gëlltitë dorëzimin eventual të postit të kryeministrit Albin Kurtit. Kjo do ta prishte bilancin delikat që i mbajti bashkë fraksionet e LDK-së. Me përzgjedhjen e Vjosa Osmanit si kandidate për kryeministre, LDK-ja ka bërë vetëm hapin e parë drejt transformimit dhe rinovimit. Po kështu, do të ishte gabim edhe nëse, siç po thonë disa, garda e vjetër e LDK-se po luan lojën me Osmanin për t'ia djegur karrierën, dhe se koalicioni, nëse arrihet, do të bazohej vetëm në kompromis dhe pazar të numrave, ku Vjosa Osmani shihet vetëm si një figurante kalimtare.

Në të vërtetë, nëse do të mendonte strategjikisht, për Kurtin do të ishte më e dobishme pozita e një eminece gri te koalicioni që ashiqare do të ishte koalicion prej zorit anti Thaçi dhe anti PDK.

Duke hyrë në pushtet si dubletë, si i dyti me rang, por me pushtetin moral në prapavijë, dhe duke mos u ekspozuar si, mbase, kryeministria në ardhje Vjosa Osmani, Albin Kurti nuk do të ishte u ekspozuar në mënyrë direkte presioneve të pashmangshme të ndërkombehtarëve dhe forcave vendore të interesuara për partneritet me ShBA-në dhe BE-në, të cilat presione edhe kanë qenë vendimtare për rrëzimin nga pushteti të Ramush Haradinajt.

Kurti do të fitonte më shumë kredit dhe përvojë për një karrierë të zgjatur politike si lider i tipit modern dhe jo si prijës popullist dhe revolucionar në zbehje në kohën që nuk tregon shenja se është revolucionare.

(Marrë nga <http://shkelzenmaliqi.com>)

Rusia dhe Turqia diskutojnë blerjen e aeroplanëve luftarakë rusë

MOSKË, 28 GUSHT - Rusia dhe Turqia janë duke diskutuar mundësinë e dërgimit të sistemeve ruse siç janë aeroplanët luftarakë, Sukhoi Su-57 dhe aeroplanët e llojit, Su-35 në Ankara, ka thënë një zyrtar rus.

Rusia ka nisur dërgimin e sistemeve të saj për mbrojtje S-400 gjatë këtij viti në Turqi, hap që ka tensionuar marrëdhëniet e Ankarasë me aleatët e NATO-s. Kjo marrëveshje është kundërshtuar edhe nga Shtetet e Bashkuara, të cilat kanë larguar Turqinë nga programi i saj për

prodhim të aeroplanëve F-35, të cilët Ankaraja po ashtu kishte planifikuar që t'i blinte.

Dmitry Shugarev, udhëheqës i Shërbimit Federal të Rusisë për Bashkëpunim Ushtarak, ka thënë se ai ka planifikuar të diskutojë me një koleg turk sistemin rus të mbrojtjes S-400, por edhe "dërgimin eventual të sistemeve, Su-35 apo Su-57."

"Është treguar shumë interes, është shumë herët për të negociuar", është cituar të ketë thënë Shugarev sipas agjencive ruse të lajmeve.

Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan, ka thënë se Turqia dëshiron të vazhdojë bashkëpunimin për mbrojtje me Rusinë, duke përfshirë aeroplanët ushtarakë, pas takimit që ka pasur me presidentin rus, Vladimir Putin.

Erdogani, i cili ka marrë pjesë në një organizim për ekspozim të aeroplanëve në Zhukovsky afër Moskës, ka pyetur liderin rus nëse mund të blihen sistemet Su-57.

"Mund ta blini", është cituar të ketë thënë Putini, sipas agjencisë së lajmeve, Interfax.



Macroni: Evropa t'i përmirësojë marrëdhëniet me Rusinë

Duke folur me diplomatët e huaj pas përfundimit të samitit të G-7-ës në Francë, presidenti francez, Emmanuel Macron tha se kontinenti evropian nuk do të jetë kurrë i qëndrueshëm dhe i sigurt nëse nuk gjen paqe dhe përmirësim të marrëdhënieve me Rusinë dhe se kjo nuk është në interes të disa prej aleatëve tanë

PARIS, 28 GUSHT - Presidenti francez Emmanuel Macron thotë se kontinenti evropian nuk do të jetë kurrë i qëndrueshëm dhe i sigurt nëse marrëdhëniet e tij me Rusinë nuk zgjidhen. Duke folur me diplomatët e huaj pas përfundimit të samitit të G-7-ës në Francë, Macroni e pranoi se disa aleatë do të refuzojnë çdo lloj bisedimesh me Rusinë për shkak të agresionit të saj në Ukrainë.

Gjatë samitit të G-7-ës, presidenti amerikan Donald Trump bëri thirrje për rikthimin e Rusisë në grupin elitari nga i cili u përjashtua pas aneksimit të gadishullit ukrainas të Krimesë në vitin 2014. Ndërhyrja e Moskës në Ukrainën Lindore ka rritur tensionet me Perëndimin. Por që nga ardhja në Shtëpinë e Bardhë, presidenti Trump ka bërë përpjekje për t'i përmirësuar marrëdhëniet me Rusinë, dhe duket se ka gjetur mbështetje tek disa udhëheqës evropianë.

"Mendoj se duhet të ndërtojmë një model të ri për sigurinë dhe besimin në Evropë. Kontinenti evropian nuk do të jetë kurrë i

qëndrueshëm dhe i sigurt nëse nuk gjen paqe dhe përmirësim të marrëdhënieve me Rusinë. Të jemi të qartë se kjo nuk është në interes të disa prej aleatëve tanë. Disa prej tyre gjithmonë do të bëjnë presion për të vendosur më shumë sanksione ndaj Moskës. Kjo është në interesin e tyre, edhe nëse ata janë miqtë tanë. Por nuk është në interesin tonë", tha presidenti francez Emmanuel Macron.

Presidenti i Këshillit të Bashkimit Evropian, Donald Tusk, politikan nga Polonia, kritikoi presidentin Trump të shtunën për sugjerimin se Rusia duhet të ftohet në takimet e G-7-ës.

"Sot, unë do të përiqem të bind bashkëbiseduesit e mi se do të ishte më mirë të ftohej Ukraina, si mysafire, natyrisht, në takimin e ardhshëm të G-7-ës për të dëgjuar mendimin e presidentit të tyre të ri, Volodymyr Zelenskiy. Bisedova me të për këtë çështje dy ditë më parë, dhe e di se ai do të ishte shumë i interesuar", tha ai. Britania gjithashtu kundërshtoi rikthimin e Rusisë në G-7.



Marrëdhëniet e Londrës me Moskën u dëmtuan pas helmimit të një ish-spiuni rus në Angli në vitin 2018, një akt flagrant për të cilin Britania fajëson Kremlinin. Macroni tha se Rusia nuk mund të pranohet në grup si anëtare e plotë për shkak të veprimeve të saj në Britani dhe Ukrainë, por ai tha se largimi i saj nga Evropa është një gabim strategjik, i cili ka bërë që Moskë të ndërtojë aleanca diku tjetër. Ai tha se Franca dëshiron ta ndryshojë këtë dhe është e gatshme të veprojë vetë

nëse Rusia i plotëson kushtet kryesore në lidhje me konfliktin në Ukrainë.

"Ta themi thjesht, ne nuk jemi një fuqi që konsideron se armiq të miqve tanë janë domosdoshmërisht edhe armiq të tanë apo se e kemi të ndaluar të bisedojmë me ta. Dhe unë mendoj se kjo është fuqia e Francës", tha ai. Macroni tha se përfaqësuesit e Rusisë, Ukrainës, Gjermanisë dhe Francës do të takohen muajin tjetër për të diskutuar rrugët drejt paqes në Ukrainë.

Këshilltari i presidentit Trump për sigurinë kombëtare, John Bolton u tha ukrainasve të martën të mos prisnin ndonjë zgjidhje nga evropianët

në një kohë të afërt. Gjatë një vizite në kryeqytetin e Ukrainës, Kiev, John Bolton tha se presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy nuk duhet të nxitojë me ndonjë veprim në Ukrainën Lindore. Ai gjithashtu tha se presidenti Trump mund të takohet me Zelenskiy gjatë një vizite në Poloni në fund të javës.

Mbretëresha i bindet Johnsonit, pezullohet Parlamenti britanik

Londër, 28 gusht - Mbretëresha e Britanisë i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së qeverisë së Boris Johnson për pezullimin e Parlamentit. Sipas BBC parlamenti do të pezullohet në shtator, sapo të përfundojnë pushimet zyrtare. Kjo lëvizje vjen si kundërpërgjigje ndaj planit të disa

deputetëve për të bllokuar largimin pa marrëveshje të Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian.

"Na duhet që të përqendrohemi në përparësitë kryesore politike dhe publike. Duhet të luftojmë krimin e dhunshëm, të investojmë në infrastrukturë dhe shkencë dhe të

zvogëlojmë koston e jetës", tha Johnsoni. Ai tha se shpreson që të arrihet një marrëveshje për Brexit në samitin e liderëve të BE-së që do të mbahet më 17-18 tetor.

Pezullimi do të thotë se deputetët nuk kanë të drejtë të kalojnë ligje dhe as të mbajnë fjalime.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Qindra drerë mblidhen çdo ditë në një park japonez, askush nuk e di pse

Në verë një park në qytetin Nara të Japonisë, ndodh një fenomen shumë i veçantë. Drejt perëndimit të diellit dhe për rreth një orë, qindra drerë mblidhen në një zonë shumë specifike të parkut dhe menjëherë pranë Muzeut Kombëtar, për t'u zhdukur pas



momentit të relaksimit. Quket shikadamari, që do të thotë "vend për mbledhjen e drerëve", dhe arsytet pse ndodh nuk janë ende të qarta. Në Parkun Nara ka rreth 1 400 ekzemplarë drerë, që e bëjnë vendin një destinacion mjaft të popullarizuar.

FOTO E DITES



Një djalë lahet në një pellg të mbuluar me alga në Kirtipur në periferi të Kathmandus /AFP/

E rrallë

Bustet e presidentëve, fluks vizitorësh në Virxhinia

Bustet e 43 presidentëve amerikanë, që renditen njëri pas tjetrit në një fushë, në Virxhinia rurale po përfshihen nga një fluks vizitorësh. Njerëzit, gjithnjë e më shumë po zgjedhin t'u bashkohen

turneve, që të shohin bustet e nxjerra jashtë përdorimit të ish-presidentëve të Shteteve të Bashkuara në Uilliamsburg të Virxhinias. Bustet, janë gjithçka që ka mbetur nga



parku i presidentëve në Uilliamsburgun kolonial, që u mbyll në vitin 2010, gjashtë vite pasi u hap për publikun.

BARSOLETA E DITËS



Më fal a keni byrek me qep?

- Jo nuk kemi.

- Ma sill një mos bo hajgare, se sa herë po lypi me mish po ma jep me qep.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman




Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30 ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Mjaft harmoni në punë ndërmjet kolegësh. Pak

problematik raporti në çift ku dikush kërkon shpjegime.



DEMI

Sot do të jenë emocionet tuaja ato

që do t'ju drejtojnë në zgjedhjet që do të bëni.



BINJAKËT

Keni mjaft mirëkuptim në

familje ku secili bën atë që i takon duke ju lënë kohë të lirë në dispozicion.



GAFORRJA

Jeni disi ëndërrimtarë gjatë

pjesës së parë të ditës. Shumë shpejt një problem do t'ju kthejë me këmbë në tokë.



LUANI

Sot po e kapni veten shumë

herë duke menduar për të shkuarën. Doni të qëndroni vetëm me kujtimet tuaja.



VI RGJËR ESHA

Jeni shumë korrekte sot me

detyrimet tuaja. Nëse do të kishit një reciprocitet dhe nga personat e tjerë dita do të ishte perfekte.



PESHORJA

Hëna në shenjë sot ju bën romantike

më tepër se zakonisht. Shumë mirë paraqitet dhe ana juaj financiare.



AKREPI

Logjika dhe racionaliteti nuk ju

mungojnë sot. Kjo do t'ju shërbejë dhe miqve tuaj që shpesh herë janë tepër impulsive.



SHIGJETARI

Sot do të keni një jetë sociale me

mjaft angazhime. Autokontrolli shumë herë ju ka privuar nga kënaqësi të vogla.



BRICJAPI

Intuita juaj po ju paralajmëron për

një ngërç të vogël në jetën në çift. Mundohuni të gjeni arsyen pse ka ndodhur.



UJORI

Sot dëshira juaj shkon tek

kreativiteti gjërat e bukura dhe udhëtimet. Do të keni nevojë për shoqëri të mirë.



PESHQIT

Sot ngado që shkoni

gjendeni në shoqëri të mirë dhe me miq të këndshëm. Do të ndiheni disi të plogësht gjatë mbrëmjes.

Neymari edhe aktor



Neymar bën realitet një prej ëndrrave të tij, shfaqjen në "Netflix". Sulmuesi brazilian që është në pritje të një zgjidhje për të ardhmen e tij sa i përket aspektit futbollistik, është shfaqur në dy episode të serialit të njohur spanjoll 'La Casa de Papel' që është pjesë e

programeve të "Netflix". Futbollisti nuk e fshehu entuziazmin e tij dhe menjëherë iu drejtua rrjeteve sociale për ta ndarë atë me fansat e tij. "Ja dola të bëjë realitet ëndrrën time që të jem pjesë e serialit tim të preferuar", ka shkruar Neymar në llogarinë e vet në "Instagram".

Jamie Foxx darkon me të dashurën dhe ish të dashurën



Ky është një takim vërtetë i rrallë. Jamie Foxx është parë duke darkuar me ish të dashurën Kristin Grannis, me të cilën ka edhe një vajzë, dhe Sela Vave, këngëtarën për të cilën është përfolur se është në lidhje dashurie. Ata janë parë në Malibu para se të

shkonin më vonë në shtëpinë e tij në Thousand Oaks të Kalifornisë. Foxx ka vajzën dhjetëvjeçare Annalise me Grannis, ndërkohë që është përfolur se ai e ka nisur një romancë me Vave kur ata janë parë duke u larguar nga një klub nate në Hollywood më 17 gusht.




Rita Ora me këtë fustan nuk i lë vend imaginatës

Këngëtarja e njohur nga Prishtina, Rita Ora, ka marrë pjesë në festivalin në Notting Hill Carnival. Rita Ora në këtë festival sipas "Dailymail" ishte e shoqëruar me yllin televiziv britanez Vas J Morgan.

Këngëtarja si në çdo paraqitje interesante të saj, ajo edhe këtë herë mori vëmendjen e të tjerëve me veshjen e saj. Këtë herë Rita veshi një fustan i cili ishte goxha i tejdukshëm dhe i vinte në pah shumë format e saj trupore.

Drake publikon këngën "Money in the grave"

Këngëtari dhe reperi i njohur, Drake, ka publikuar këngën e tij më të re. "Money in the grave" është kënga e cila është bashkëpunim me artistin Rick Ross. Regjinë e videoklipit të këngës e ka bërë Theo Skudra.





Ad: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Kosova ndaj Turqisë luan për fitore

Futbollistët e Kosovës të premtën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" e ndajnë mejdantin me futbollistët e Turqisë. Përzgjedhësja Afërdita Fazlija ka kërkuar fitore në këtë ndeshje. "Sigurisht se kjo ndeshje do të jetë mjaft cilësore nga të dyja skuadrat, por pres që ne t'i gëzohemi fitores. Nuk mund ta themi se na kanë futur nën presion rezultatet e përfaqësueses së meshkujve, pasi ato vetëm sa e kanë motivuar ekipin tonë", ka thënë Fazlija



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 28 GUSHT - Përzgjedhësja e përfaqësueses së Kosovës në konkurrencën e femrave, Afërdita Fazlija, është optimiste se vashat që i drejton mund të shënojnë fitore ndaj Turqisë. Ndeshja në mes të Kosovës dhe Turqisë është e vlefshme për kualifikimet "Euro 2021" dhe zhvillohet të premtën nga ora 20:00 në stadiumin "Fadil Vokrri". "Sigurisht se kjo ndeshje do të jetë mjaft cilësore nga të dyja skuadrat, por pres që ne t'i gëzohemi fitores. Nuk mund ta themi se na kanë futur nën presion rezultatet e përfaqësueses së meshkujve, pasi ato vetëm sa e kanë motivuar ekipin tonë", ka thënë Fazlija, e cila e ka rikujtuar edhe përballjen e fundit ndaj Turqisë. "Para dy vjetësh kemi zhvilluar një ndeshje miqësore me

Turqinë, por që nga atëherë progresi ynë është evident", ka shtuar ajo.

Në krah të përzgjedhësës në konferencë për medie ishte edhe kapitenia e Kosovës, Valentina Limani. Edhe limani është optimiste se futbollistët "dardane" kanë potencial për të fituar në përballje me futbollistët turke. "Besoj se vajzat janë shumë të motivuara. Mendoj se do ta japim maksimumin. Duhet t'i kryejmë detyrat që na thotë trajneri dhe besoj se në fund do të dalim triumfues. Skuadra është e bashkuar, andaj shpresojmë në rezultat pozitiv", ka deklaruar Limani.

Për ndeshjen që zhvillohet të premtën është deklaruar edhe futbollistja Erlenda Memeti: "E dimë se Turqia ka një përvojë më të madhe, por besoj se do ta kemi përkrahjen e tifozëve dhe në fund do t'i gëzojmë me fitore".

Të mërkurën përzgjedhësja e Kosovës, Afërdita Fazlija, së bashku me ndihmësit e saj, Veton Çitaku, Sanije Krasniqi dhe Besart Ismajli, kanë mbajtur dy stërvitje në stadiumin e "Agron Rama" në Obiliq, kurse duhet cekur se bën pjesë në Grupin A, së bashku me Holandën, Rusinë, Turqinë, Slloveninë dhe Estoninë.

Lista e futbollisteve

Besarta Leci, Lavdije Behramaj, Florentina Kolgeci, Fjolla Shala, Lirdona Sylja, Egzona Zeka, Donjeta Halilaj, Feride Kastrati, Verona Berisha, Flutura Agaj, Blerta Shala, Valentina Limani, Leonora Ejupi, Modesta Uka, Besarta Hisenaj, Qendresa Bajra, Erlenda Memeti, Besiana Reçica, Alberina Sylja, Kaltrina Biqkaj, Flaka Aslanaj, Fleta Musaj.

SHKURT

Jansseni përforcon KB Prishtina

Kampionia e Kosovës në basketboll, Prishtina, ka konfirmuar se është përforcuar me basketbollistin nga Australia, Jonathan Janssen. "Lojtari me prejardhje nga Australia, Jonathan Janssen, i gjatë 205 cm, është përforcimi më i ri i klubit tonë. Me përvojën e fituar në sezonin e fundit në Superligën e Zelandës së Re, përkatësisht në klubin Canterbury Rams, alo-ja Janssen pritet të jetë ndihmesë e madhe për KB Prishtinën", thuhet në njoftimin e KB Prishtina.

Trajneri i Çekisë vlerëson Kosovën

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të përballë me 7 shtator me Çekinë në stadiumin "Fadil Vokrri". Trajneri i Çekisë, Jaroslav Silhavy, ka folur për këtë ndeshje duke i vlerësuar maksimalisht "Dardanët". "Ne kemi rivalë me të vërtetë sfidues. Në veçanti, Kosova, e cila është më e afërt me ne në tabelë dhe është situatë e rrezikshme. Por besoj se mund ta kontrollojmë", ka thënë Silhavy.

Kosova kërkon kualifikimin me fitore ndaj Andorrës

Ekipi i Kosovës (meshkujt) në beach volley në përbërje Faton Mustafa dhe Armend Berisha, ndeshjen e radhës në Lojërat Mesdhetare në Rërë "Patra 2019", do ta zhvillojë sot (e shtunë) ndaj Andorrës. Kosova takimin e parë e humbi nga Portugalia 2:0. Humbje pësoi edhe Andorra ndaj Francës, me të cilat ekipi i Kosovës përbën grupin B. Nëse Kosova mposht Andorrën do të vazhdojë tutje garat.

Kosova pëson disfatë nga Sllovenia në 'Patras 2019'

Ekipi i vajzave të Kosovës në beach volley, i përbërë nga Valmira Ramadani dhe Dhuratë H. Sylejmani, pësuan humbje nga dyshja sllovene, Fabjan - Kregar, 2:0 në sete (21:16 dhe 21:17), në ndeshjen e parë të grupit B të Lojërave Mesdhetare në Rërë, "Patra 2019". Takimin e përcollën nga afër drejtuesit e lartë të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Federatës së Volejbollit të Kosovës. "Ekipi ynë tregoi paraqitje të mirë dhe deri diku ishte rival i barabartë me sllovenet", thuhet në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës.

Trepça kërkon rikthimin e Hajrizit

MITROVICË, 28 GUSHT - KB Trepça ka filluar riorganizimin për edicionin e ri basketbollistik 2019/2020. Skuadra nga Mitrovica ditë më parë ka njoftuar se është në bisedime me disa biznese, kurse sot ka bërë me dije se po kërkon

përkrahje për rikthimin e basketbollistit të njohur Drilon Hajrizi. "KB Trepça po bën angazhim maksimal që t'i rikthejë në klub Drilon Hajrizin dhe Musab Malan. Kërkojmë përkrahjen edhe të bizneseve që ta kthejmë klubin aty ku e ka

vendin", thuhet në njoftimin e klubit mitrovicas. Hajrizi me skuadrën e Trepçës e kishte fituar titullin e kampionit, kurse më pas ka bërë karrierë të suksesshme edhe në KB Peja, KB Prishtina, KB Bashkimi dhe në Kinë.



Sot takohen Dukagjini - Drita

KLINË, 28 GUSHT - Ndeshja ndërmjet Dukagjinit dhe Dritës, e cila zhvillohet sot (e premte) në stadiumin "18 Qershori" në Klinë, do ta hapë

javën e 3-të në IPKO Superligë. Ndërkohë, tri ndeshje do të luhen të shtunën, ndër të cilat edhe dueli ndërmjet kampionit dhe

nënkampionit të edicionit të kaluar, Feronikelit dhe Prishtinës. Ndërsa të dielën zhvillohen dy ndeshjet e fundit të kësaj jave, ku takohen

Trepça'89 - Drenica dhe Gjilani - Vushtrria, pas të cilave skuadrat do të pushojnë për shkak të ndeshjeve të përfaqësueses.



Sot shorti i Ligës së Kampionëve

NYON, 28 GUSHT - Shorti për fazën e grupeve të edicionit 2019/20 të Ligës së Kampionëve do të mbahet të enjten, më 29 gusht, në orën 18:00. Të përfshira do të jenë 32 klube, të cilat do të ndahen në tetë grupe me nga katër klube. 26 klube që e siguruan pjesëmarrjen në këtë edicion të Ligës së Kampionëve përmes sukseseve të sezonit të kaluar janë: Barcelona, Real Madridi, Atletico Madridi, Valencia, Liverpools, Chelsea, Manchester City, Tottenhami, Juventus, Napoli, Interi, Atalanta, Bayern Munich, Borussia Dortmundi, Bayer Leverkuseni, RB Leipzig, Paris Saint-Germaini, Lyon, Lille, Zeniti, Lokomotiv Moscow, Benfica, Shakhtar Donetsk, Genku, Galatasaray and RB Salzburg. Ndërsa, gjashtë skuadra të tjera do t'i shtohen kësaj liste pas përfundimit të fazës "play-off"-s. Deri më tani kualifikimin në fazën e grupeve e kanë siguruar Crvena Zvezda, Olympiacos dhe GNK Dinamo, kurse pritet konfirmimi edhe për tri të tjerat. Skuadra do të ndahen në katër vazo, të cilat caktohen ose nga shumica e pikëve të fituara gjatë pesë vjetëve të fundit ose nga koeficienti i Federatës së tyre gjatë së



njëjtës periudhë kohore.

Në vazën e parë radhiten kampioni i Ligës së Kampionëve, kampioni i Ligës së Evropës dhe kampionët e gjashtë ligave më të mëdha në botë. Radhitja në tri vazot e tjera varet nga koeficienti i

klubeve. Asnjë klub s'mund të luajë kundër ndonjë klubi nga i njëjti vend. Për më tepër, sipas vendimit të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s, klubet nga Rusia dhe Ukraina s'do të lejohen të luajnë kundër njëri-tjetrit.

DATA KUR ZHVILLOHEN NDESHJET:

17/18 shtator: Faza e grupeve, ndeshja e parë
1/2 tetor: Faza e grupeve, ndeshja e dytë
22/23 tetor: Faza e grupeve, ndeshja e tretë
5/6 nëntor: Faza e grupeve, ndeshja e katërt
26/27 nëntor: Faza e grupeve, ndeshja e pestë
10/11 dhjetor: Faza e grupeve, ndeshja e gjashtë
Finalja e këtij edicioni do të zhvillohet më 30 maj, në stadiumin "Ataturk Olimpiyat Stadi" në Stamboll.

SHKURT

Messi mungon edhe një muaj

Lionel Messi nuk është në gjendje ta ndihmojë skuadrën e Barcelonës edhe për disa ndeshje. Argentinasi është në fazën e rikuperimit, por duket se kjo do të marrë kohë dhe Messi të mos paraqitet për Barcelonën edhe për një muaj. Ndeshjet që pritet t'i humbasë ylli argjentinas janë ndaj Osasunës, Valencias, Granadës dhe Villarrealit, por mund ta humbasë edhe ndeshjen e parë në Ligën e Kampionëve.

Lakersat e rikthejnë Howardin

Los Angeles Lakers ka konfirmuar se ka arritur një marrëveshje me basketbollistin 33-vjeçar Dwight Howard. Bëhet fjalë për një rikthim të shtatartit, që ka luajtur edhe më parë në ekipin kalifornian (2012-2013). Kontratë njëvjeçare për Howardin, që fiton një rrogë minimale të vendosur nga NBA. I njohur me nofkën "Superman" (2.11 metra i gjatë), Howard në karrierën e tij ka një mesatare prej 17.4 pikësh, 12.6 reboundesh dhe 2 blloqe për ndeshje.

Ibrahimoviqi: Nëse Unitedi ka nevojë për mua, këtu jam

Ylli i LA Galaxy, Zlatan Ibrahimoviqi, ka hapur derën për një rikthim të mundshëm te Manchester Unitedi. Sulmuesi suedez ka shijuar një sezon të jashtëzakonshëm në MLS dhe beson se ai është akoma mjaft i mirë për të luajtur në Ligën Premierë. Ai me shaka shtoi se Unitedi, nëse ka nevojë për të, ai është gati për një rikthim. "Ende mund të luaj lehtë në Ligën Premierë. Nëse Unitedi ka nevojë për mua, unë jam këtu! Por, Galaxy më ka mua, kështu që më vjen keq. Unë bëra punën time në Evropë. Më pëlqen, kam 33 trofe që solla me vete këtu dhe shpresoj se mund të fitoj edhe këtu. Atëherë do të shohim se ku mbaron kjo aventurë", ka thënë Ibrahimoviqi.

PSG-ja në bisedime me Mandzukiqin

Paris Saint-Germain ka nisur bisedimet me Juventusin për transferimin e mundshëm të sulmuesit kroat, Mario Mandzukiq. Gjiganti francez ka nevojë për përf forcime në sulm pas lëndimeve të Kylian Mbappes e Edinson Cavanit, derisa e ardhmja e Neymarit ende nuk është vendosur. Di Marzio raporton se PSG-ja ka shprehur interesim për 33-vjeçarin që nuk është në planet e Sarrit pas rikthimit të Gonzalo Higuainit.

Nadali fiton me lehtësi, befason Thiemi

Në Nju Jork janë luajtur sot ndeshjet e radhës së raundit të parë të grand slamit të US Open. Tenisti spanjoll Rafael Nadal fitoi me lehtësi 3-0 (6-3, 6-2, 6-2) ndaj australianit John Millman. Ndeshje e mirë e Nadalit, që në të tre setet pati epërsi në fushë, duke e merituar fitoren. E papritura më e madhe ishte eliminimi i numrit 4 në botë, austriakut Dominic Thiem, i cili u mund 3-1 nga italianii Thomas Fabbiano (6-4, 3-6, 6-3, 6-2). Një ndeshje e dobët e Thiemit, i cili nuk dha atë që pritej në fushë, duke i thënë shpejt "lamtumirë" turneut. Në raundin e dytë shkon australiani Nick Kyrgios, që mundi 3-0 Steve Johnsonin, ndërkohë që surprizë është edhe eliminimi i grekut Stefanos Tsitsipas. Ballkanasi u mund 3-1 nga Andrey Rublev. Fiton edhe tenisti gjerman Alexander Zverev, numri 5 në botë, i cili mposhti 3-2 Radu Albot. Një biletë për më tej ka siguruar edhe francezi Gael Monfils (3-0 ndaj Albert Ramos), por u eliminuan dy patriotët e tij: Jo-Wilfried Tsonga dhe Richard Gasquet. Në raundin e dytë avancojnë edhe kroati Marin Cilic, fitues i US Open në vitin 2014 si dhe spanjollli Fernando Verdasco.

Përplasesen pilotët e Hondas



CERVERA, 28 GUSHT - Marrëdhënia mes dy pilotëve spanjoll të Hondas, Marc Marquez dhe Jorge Lorenzo, ka pësuar të mërkurën një tjetër krisje të fortë. Lorenzo, pas dëmtimit në Assen, u rikthye këtë fundjavë në pistën e Silverstones, pas dy muajsh pushim. Sërish paraqitja e tij ishte e dobët, ndërkohë që Marquezi u

rendit i dyti dhe kryeson botërorin. Kjo paraqitje e dobët ka shtuar njëkohësisht zërat se Lorenzo mund të rikthehet te Ducati. Ai që ka komentuar këtë transferim të mundshëm është Marquezi. "Jorge duhet të përballet me problemet, në të mirë dhe të keqe dhe jo t'i anashkalojë ato. Kur bën pjesë në një projekt fitues si ky i

Hondas, duhet ta ndjekësh atë. Ai mban të shkruar në kaskën e vet një frazë të fortë (nuk jam një pilot i madh, jam një kampion) dhe duhet ta tregojë se është vërtet i tillë. Duhet ta tregojë besimin te ky projekt dhe ta çojë atë deri në fund dhe jo ta braktisë para vështirësive", ka thënë Marquezi.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Deklaro saktë tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat, të cilët merren me aktivitetet afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor janë të detyruar të deklarojnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përcqendrohen pikërisht te kategoritë, si: Nën-deklaruesit e pagave të punëtorëve, nën-deklaruesit tek bizneset e mesme dhe të mëdha, nën-deklaruesit tek bizneset mikro dhe të vogla, me qëllim të identifikimit të atyre bizneseve, të cilat nën deklarojnë të ardhurat e tyre.

Disa nga veprimtaritë në vijim, nuk zbatojnë këtë obligim, prandaj ATK, u bënë thirrje që të deklarojnë apo korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përbushin të gjitha obligimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor:

- Identifikimi i bizneseve, të cilat nën-deklarojnë pagat e punëtorëve;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim, në veçanti veprimtaritë, si: tregti, shërbime, ndërtimtaritë dhe prodhim;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht në kuotën fikse prej 37.5€ në çdo 3 muaj;
- Identifikimi dhe trajtimi i bizneseve, të cilat bëjnë nën-deklarim të qarkullimit me qëllim të qëndrimit vazhdimisht nën pragun e TVSH-së, veçanërisht bizneset në veprimtaritë, si: tregti, shërbime profesionale, zbavitëse-artistike, prodhim, transport, etj;
- Identifikimi i bizneseve, të cilat operojnë me humbje, si dhe bizneseve që deklarojnë me zero;
- Identifikimi i bizneseve të cilat ofrojnë furnizime pa të drejtën e kreditimit të TVSH-së, ndërsa në anën tjetër zbrasin TVSH-në në blerje;
- Identifikimi i bizneseve të cilat importojnë apo tregtojnë mallra me akcizë, të cilët përmes dokumentacionit jo të saktë, respektivisht nënverësimin të çmimeve të shitjes, i'u shmangen detyrimeve tatimore;
- Identifikimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e tekstilëve dhe veshmbathjeve, të cilat mbajnë dokumentacione jo të sakta me qëllim të shmangies së detyrimeve tatimore, etj;
- Identifikimi dhe trajtimi i personave, të cilët nuk bëjnë deklarimin e të ardhurave të ndryshme që ata mund të kenë qoftë të hyrat nga jashtë vendit, të hyrat nga kapitali apo të hyrat tjera.

ATK, inkurajon të gjitha kategoritë e lartpërmendura që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare, siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

ATK, në bashkëpunim me FMN, në implementim të Projektit "Përbushja në Sektorin e Ndërtimtarisë"!

Administrata Tatimore e Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Bazuar në Ligjin e Punës me Nr. 03/L-212, Udhëzimin Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Qarkoren Administrative 01/2014, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

K O N K U R S

I. DEPARTAMENTI PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

1. Pozita: Vozitës - 1 (një) vend pune
Referenca: MD/DFSHP/29 - 08 - 01- 2019
Koefficienti: 5.5
I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike
Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron shërbime të vozitjes në bazë të rregullave të komunikacionit;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e automjetit që përherë të jetë i gatshëm për përdorim;
- Mbanë evidencën - shënimet për lëvizshmërinë e veturës;
- Plotëson formularët lidhur me veturën zyrtar;
- Mbledhë dokumentacionin dhe fletë-udhëtimet, si dhe të njëjtat i'a dorëzon përgjegjësit të transportit;
- I dorëzon raportin me shkrim zyrtar kompetent lidhur me shpenzimet dhe mirëmbajtjen;
- Zbaton aktet ligjore dhe nënligjore të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe obligimet e Nëpunësit Civil;
- Ofron shërbime të vozitjes edhe për Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet, rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohë nga mbikëqyrësi;
- Për punën e vet i përgjigjet Udhëheqësit të Divizionit;

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkallësimet tjera:

- Diploma e Shkollës së mesme;
- Patentë shoferi për kategorinë "B", e obligueshme;
- Një (1) vit përvojë pune;
- Njohja e mire e gjuhëve në përdorim zyrtar në Republikën e Kosovës;

Marrja dhe dorëzimi i Aplikacioneve: Ministria e Drejtësisë / Divizioni për Burimeve Njerëzore, Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes » kati i 8 (tetë), Zyra Nr. 803, Prishtinë, Kosovë;
Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 - 200 182 86, prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetat ditore, duke filluar nga data 29.08.2019 gjer më datën 12.09.2019, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 (katër) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurron.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Na osnovu zakona o radu 03/L-212 i na Administrativnom Upustvu br.07/2017 o regulisanje procedura Konkursa na Javnom Sektoru i Cirkularno Administrativno pismo br. 01/2014, Ministarstvo Pravde ojavljuje:

K O N K U R S

I. DEPARTMAN ZA FINANCJE I OPSTE SLUZBE

1. Pozicija: Vozač - 1 (jedno) radno mesto
Referenca: MP/DFOS/29 - 08 - 01 - 2019
Koefficientat: 5.5
Odgovara: Rukovodilac Divizija za informativno tehnologiju i logističke usluge
Mesto: Prishtine

Zadaci i odgovornosti:

- Pruža vozačke usluge na osnovu saobraćajnih pravila;
- Brine se za održavanje vozila tako da one budu uvek spremna za upotrebu;
- Vodi evidenciju-beleške o kretanju vozila;
- Ispunjava formulare povezanim sa službenom vozilom;
- Prikuplja dokumentaciju i putne - naloge, i iste ih dostavlja kod nadležnog službenika za transport;
- Podnese pismeni izveštaj nadležnom službeniku o troškovima i održavanju
- Izvršava zakonske i podzakonske akte koji se odnose na prava i obaveze civilnih službenika;
- Pruža vozačke usluge i za kancelariju Generalnog Sekretara ;
- Obavlja i druge poslove u skladu sa zakonima i propisima, na opravdan način, povremeno, na zahtev nadzornika;
- Za svoj rad odgovornost daje kod rukovoditelja divizije.

Uslovi, kvalifikacija, iskustvo, sposobnost i lične karakteristike:

- Diploma srednje škole;
- Vozačka dozvola , kategorija "B" je obavezna;
- Jedna (1) godina radnog iskustva;
- Poznavanje albanskog ili srpskog jezika.

Prijem i predaja aplikacije: Ministarstvo Pravde/Divizija Ljudskih Resursa, Adresa Bivsa Zgrada „Rilindja“ Osmi (8) Sprat, Kancelarija Br. 803, Priština, Kosovo;
Za detaljnije informacije možete kontaktirati Kancelariju Divizije Ljudskih Resursa na tel: 038 200 182 86, svakog radnog dana od 08:00 - 16:00 časova.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednom od dnevnih novina, odnosno počev od 29.08.2019 do 12.09.2019, koji dan se smatra posljednjim danom zaključenja konkursa.

Prijavci poslate poštom, koje sadrže poštanski žig o slanju posljednjeg dana odnosno roka za aplikaciju, smatraće se blagovremenim i uzet će se na razmatranje ukoliko stignu u roku od 5 (pet) dana, prijave koje stignu van ovog roka neće se uzeti na razmatranje.

Uz aplikaciju se podnose kopije dokumenata o kvalifikaciji, radnom iskustvu, i druga potrebna dokumenta koje zahteva radno mesto za koje se konkurise.

Kandidati koji će biti selektirani i izabrani za uži spisak biće pozvani na intervju pismeno ili putem telefona u zakonskom roku od strane Divizije za Ljudske Resurse i obavezno sa sobom treba da uzimaju originalna dokumenta o završenim kvalifikacijama i obukama za verifikaciju od strane komisije za intervju.

„Civilna Služba Kosova služi svim stanovnicima Kosova, i pozdravlja Aplikacije žena i muškarca svih zajednica Kosova“.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministraskvo Pravde - Ministry of Justice



